- D)Renale

105.Në një radiografi direkte abdomeni, cila është shenja që tregon dyshim klinik të okluzionit intestinal:

- A)Opacitet abdominal i përhapur
- B)Radio transparencë abdominale e përhapur
- C)Nivele hidroaerike abdominale
- D)Linjë ajri subdiafragmatik

106.Në rast traume muskulare me suspekt hematome në pulpën e këmbës, cila metodë është më e përshtatshme:

- A)Skaner pa kontras
- B)Skaner me kontrast
- C)Radiografi konvencionale
- D)Ekografi

107.Nëse dyshohet për perforacion intestinal, cili është ekzaminimi i parë që duhet kërkuar në urgjencë:

- A)Ekografi abdominale
- B)Radiografia e traktit tretës me sulfat bariumi
- C)Klizmë me dopio kontrast

D)Radiografi direkte abdomeni

108.Cili ekzaminim është më i indikuar për ndjekjen e pacientit me pankreatit akut:

- A)ERCP
- B)Kolangio rezonanca
- C)Kolangiografia
- D)Ekografia

109.Në një pacient mbi 50 vjeç me episode hematurie dhe që ekografikisht nuk rezulton kalkuloze renale, cili është ekzaminimi që duhet kryer:

- A)Radiografi e aparatit urinar
- B)Ekografi me kontrast
- C)Urografi
- D)Uro Skaner

110.Nëse dyshohet për frakturë menisku post traumatik, cili ekzaminim duhet kryer:

- A)Radiografi koinvencionale
- B)Rezonance magnetike
- C)Ekografi
- D)Skaner i artikulacionit

111.Në një grua me diagnozë mamografike të mikroklacifikimeve parenkimale, cili ekzaminim rekomandohet më pas:

- A)Galaktografia
- B)Biopsia nën eko
- C)Biopsia stereotaksike
- D)Ekografia

112.Gjatë kryerjes së projeksionit AP axial oblik për vertebrat cervikale për një pacient traumatik supin, si duhet të drejtohet rrezja qendrore nëse përdoret vetëm një kënd:

- A)15 gradë cefalik
- B)45 gradë cefalik
- C)15 gradë lateromedialisht
- D)45 gradë lateromedialisht

113.Gjatë kryerjes së projeksionit AP të abdomenit në një pacient traumatik, çfarë duhet të përftohet përpara se të lëvizet pacienti në tavolinën radiologjike:

- A)shenjat vitale
- B)miratim me shkrim nga pacienti
- C)leje nga mjeku ndjekës
- D)vertebra cervikale laterale, pozicioni decubitus dorsal

114.Cila nga procedurat e mëposhtme duhet të performojë radiografi, nëse një pacient traumatik ka gjakosje nga plaga:

- A)Të mbrojtë kasetën me plastikë
- B)Të mbyllë kasetën brenda një jastëk - cantë

- C)Të sigurojë likide për pacientin oralisht ose në rrugë intravenoze
- D)Personeli i dhomës së emergjencës të asistojë në procedurë

115.Përse duhet të përdoret pozicioni decubitus lateral i majtë për të treguar ajrin e lirë brenda në kavitetin abdominal:

- A)Ajri i lirë do të mblidhet nën hemidiafragmën e majtë
- B)Nivelet e fluidit do të mblidhen nën hemidiafragmën e djathtë
- C)Densiteti i heparit siguron kontrast të mirë për ajrin e lirë
- D)Densiteti i stomakut siguron kontrast të mirë për ajrin e lirë

116.Gjatë kryerjes së projekcionit AP të abdomenit në pozicionin decubitus lateral i majtë, cila nga procedurat e mëposhtme duhet të kryhet ku në interes të parë është niveli i likidit:

- A)Sigurohu që e gjithë ana e majtë të tregohet
- B)Sigurohu që e gjithë ana e djathtë të tregohet
- C)Centro kasetën 10 cm mbi crista iliaca për të përfshirë diafragmën
- D)Sigurohu që pacienti do ta pijë të gjithë gotën me ujë përpara së të bëhet radiografia

117.Cili projeksim i abdomenit duhet të kryhet për të treguar nivelin e ajrit apo fluidit, kur një pacient traumatik është i paaftë të pozicionohet në pozicionin vertikal apo lateralin recumbent:

- A)AP
- B)AP oblik i majtë
- C)AP oblik i djathtë
- D)Lateral, pozicioni dorsal decubitus

118.Kur kryhet projeksimi AP për pelvisin në një pacient traumatik, cila nga procedurat e mëposhtme nuk duhet kryer:

- A)Përdor një grillë direkt nën pacientin
- B)Rrotullo femurin 15 gradë medialisht
- C)Transfero pacientin në një tavolinë radiografike
- D)Centro kasetën në nivel 5 cm inferior cristës iliace anterosuperior

119.Cfarë veprimi duhet të realizojë një radiolog, nëse një pacient traumatik gjysmë i vetëdijshëm fillon të vjellë gjatë procedurës radiografike:

- A)Siguro shenjatat vitale
- B)Jepi pacientit një cantë plastike
- C)Lëvizte pacientin në pozicionin ulur
- D)Rrotulloje pacientin në pozicionin recumbent lateral

120.Cilën nga procedurat e mëposhtme duhet të performojë një radiograf, në një pacient traumatik me një dëmtim në kokë që shfaq pupila të pabarabarta:

- A)Jepi pacientit një gotë me ujë
- B)Lëviz pajisjen e imobilizimit
- C)Informo menjëherë mjekun kurues
- D)Rrotullo pacientin në pozicionin recumbent lateral

121. Cila nga procedurat e mëposhtme të craniumit do të tregonte më mirë, një frakturë të dyshuar të craniumit posterior:

- A) AP
- B) PA
- C) AP axial, Metoda Towne
- D) Lateral, pozicioni decubitus dorsal

122. Cila linjë e pozicionimit të kokës duhet të jetë afërsisht perpendikulare me kasetën gjatë kryerjes së projekcionit acantioparietal (metoda Reverse Waters), për kockat faciale të një pacienti traumatik supin:

- A) Mentomeatal
- B) Orbitomeatal
- C) Glabellomeatal
- D) Infraorbitomeatal

123. Si duhet të drejtohet rrezja qendrore gjatë performimit të projekcionit acantioparietal (metoda Reverse Waters), për kockat faciale në një pacient traumatik supin:

- A) 37 gradë cefalik
- B) Perpendikular me kasetën
- C) Paralel me linjën mentomeatale
- D) Paralel me linjën infraorbitomeatale

124. Cila nga rregullat e përgjithshme të mëposhtme duhet të ndiqen gjatë radiografimit të gjymtyrëve të sipërme apo të poshtme, në një pacient traumatik:

- A) Gjithnjë përfto dy radiografi, 90 gradë secila
- B) Gjithnjë poziciono për një projekcion të vërtetë AP dhe lateral
- C) Gjatë demostrimit të kockave të gjata, gjithnjë lëviz pajisjen e imobilizimit
- D) Gjatë demostrimit të kockave të gjata, gjithnjë transfero pacientin në tavolinën radiologjike

125. Cila pajisje përdoret me shpesh, për të matur ekspozimin hyrës në lëkurë (ESE):

- A) Dhoma e jonizuar
- B) Densitometri
- C) Matësi geiger
- D) Densitometri termoluminueshent (TLD)

126. Cili nga ekzaminimet radiologjike prodhon ekspozimin hyrës më të vogël, në lëkurë:

- A) Kafka
- B) Toraxi
- C) Urografia retrograde
- D) Colona vertebrale toraxike

127. Cili ekzaminim radiografik prodhon dozën më të lartë mesatare, për palcen:

- A) Kafka
- B) Toraxi
- C) Humerus
- D) Colona vertebrale lumbare

128.Cili nga ekzaminimet radiografike prodhon dozen me të lartë fetale:

- A)Kafka
- B)Toraxi
- C)Kolecista
- D)Colona vertebrale lumbare

129.Ku duhet ta vendosë një radiograf dozimetrit, gjatë procedurës së fluoroskopisë:

- A)Nën përparësen e plumbit, në nivel të belit
- B)Nën përparësen e plumbit, në nivel të qafes
- C)Mbi përparësen e plumbit, në nivel të belit
- D)Mbi përparësen e plumbit, në nivel të qafes

130.Ku duhet ta vendose radiologia shtatëzanë një 'shenues në fetal' (monitor fetal), gjatë procesit të fluoroskopisë:

- A)Nën përparësen e plumbit, në nivel të belit
- B)Nën përparësen e plumbit, në nivel të qafes
- C)Mbi përparësen e plumbit, në nivel të belit
- D)Mbi përparësen e plumbit, në nivel të qafes

131.Cili ekzaminim radiografik, prodhon ekspozimim më të lartë ndaj radiologut:

- A)Kafka
- B)Fluoroscopia
- C)Urografia ekskretore
- D)Colona vertebral lumbare

132.Nëse dyshohet për ikter obstruktiv, cili ekzaminim preferohet të kryhet i pari:

- A)Kolangiografisë
- B)Skaner abdomeni pa kontrast
- C)Ekografia abdomeni
- D)Skaner abdomeni me kontrast

133.Në një grua 25 vjeç me një nodul mamar të prekshëm, cili është ekzaminimi më i indikuar:

- A)Galaktografia
- B)Ekografia
- C)Mamografia
- D)Rezonanca

134.Gadolinio e përshkron barrierën hemato encefalike në:

- A)Rastet e tumoreve
- B)Kur është dëmtuar barriera hematoencefalike dhe në disa raste të tumoreve
- C)Asnjëherë
- D)Gjithmonë

135.Cili ekzaminim është më i indikuar në rast të ndjekjes së komplikacioneve të një pankreatiti akut:

- A)Ekografia abdominale
- B)Radiografia abdominale
- C)Kolangiorezonanca
- D)Skneri me lëndë kontrasti

136.Në filmat dixhitale elementi që nuk duhet të mungojë absolutisht është:

- A)Emri i institucionit spitalor
- B)Tipi i ekzaminimit
- C>Data e ekzaminimit
- D)Emri i pacientit

137.Në një pacient 70 vjec me gjak okult pozitiv në fece dhe me dyshim për tumor intestinal, cili është ekzaminimi i parë që duhet kryer:

- A)Irigografia me kontrast unik
- B)Irgografia me dopio kontrast
- C)Kolonsigmoidoskopia
- D)Skner abdomeni me kontrast

138.Në një pacient me metastaza kockore cili është ekzaminimi që vlerëson më mirë përhapjen e sëmundjes:

- A)Skner me kontrast i të gjithë trupit
- B)Skner pa kontrast i të gjithë trupit
- C)Shintigrafia kockore skeletike
- D)Rezonancë e kollonës lumbare

139.Cilat janë burimet e energjisë që përdoren në MRI:

- A)Infrared
- B>Fusha magnetike dhe valët e radios
- C)Rrezatimi jonizues
- D)Ultratingujt

140.Cili është aspekti radiografik tipik i likuidit pleural në radiografinë e pulmonit në pozicion ortostatik:

- A)opacitet modular
- B)zonë radiotrasparente apikale
- C)zonë radiotrasparente bazale
- D)opacitet bazal me kufij të sipërm konkav

141.Në patologjitë koronare acute cili ekzaminim konsiderohet i standartit të lartë për të vlerësuar anatominë e koronareve:

- A)Kardio CT
- B)Ekokardiografia
- C)Kardio MRI
- D)Koronarografia

142.Në një pacient me kolika renale acute cili është ekzaminimi i parë që realizohet:

- A)Pielo MRI
- B)Uro MRI
- C)Ekografi
- D)Urografi

143.Në pacientin me arteropati obliteante periferike, cili është ekzaminimi më i mirë për t'u kryer:

- A)Angio MRI
- B)Angio CT
- C)Ekokolor Doppler
- D)Angiografi

144.Cili ekzaminim indikohet për të vlerësuar funksionin renal:

- A)Uro CT
- B)Shintigrafia renale
- C)Urografia
- D)Uro MRI

145.Cili është ekzaminimi i parë që realizohet në një pacient me trauma kraniale:

- A)Radiografi crani
- B)MRI e trurit
- C)CT bazale
- D)CT me contrast

146.Nëse dyshohet për sëmundje inflamatore kronike intestinale, cili ekzaminim duhet kryer për të përfutur një diagnozë me të saktë:

- A)Entero MRI
- B)Radiografi e aparatit tretës
- C)Kolonsigmoidoskopi
- D)Ekografi me contrast oral

147.Nëse dyshohet klinikisht për emboli pulmonare cili është ekzaminimi që na jep diagnozën më të saktë:

- A)Radiografi toraksi
- B)Angio CT e toraksit
- C)Ekokardiografia
- D)Ekografia trase zofageale

148.Kolangio MRI kërkon:

- A)Përdorimin e lëndës së kontrastit
- B)Mospërdorimin e lëndës së kontrastit
- C)Kateterizimin e vijave biliare
- D)Përdorimin në ikterin hepatoqelizor

149.Në rast së dyshohet për perforacion gastric, cili është ekzaminimi i parë që realizohet:

- A)Radiografi me sulfat barium



- B)Radiografi direkte abdomen në këmbë
- C)CT abdominal
- D)Ekografi

150.Nëse dyshohet për limfonoduj mediastinale, cila metodikë është më e përshtatshme për të vlerësuar mediastinin:

- A)Ekografia
- B)CT
- C)Ekodopler me contrast
- D)Radiografi direkte e toraksit

151.Kriteret radiologjike të malinjitetit të një nodusi pulmonary të paqartë, janë:

- A)Formë e çrregullt
- B)Konture të çrregullt
- C)Mungesa e kalcifikimeve apo kalcifikime qëndrore
- D)Të gjitha

152.Galaktografia:

- A)Duhet të kryhet gjithmonë kur ka sekrecione seroze pluriorificiare
- B)Kërkohet para interventit për të përcaktuar vendin e tumorit dhe parenkimën përreth
- C)Kryhet në rast të pranisë së sekrecioneve mono orificiare
- D)Kryhet nën kontrollin ekografik

153.Nëse dyshohet klinikisht për rupturë të aneurizmës së aortës abdominale nën arterien renale, cili ekzaminim duhet kryer:

- A)Radiografi direkte abdomen
- B)CT me contrast
- C)MRI
- D)Angiografi

154.Koha e përgjysmimit fizik të një izotopi radioaktiv, është:

- A)Koha kur radioaktiviteti fillestar reduktohet me 50%
- B)Koha kur lënda radioaktive zhduket plotësisht
- C)Koha brenda së cilës radioizotopi është i përdorshëm
- D)Asnjëra

155.Në studimin e retroperitoneumit metoda diagnostike e preferuar, është:

- A)Urografi
- B)CT
- C)Ekografi
- D)MRI

### **3. Metodologjia në Radiologji**

1.Flebografia preferohet të kryhet me kontrast me:

- A)Osmolaritet të ulët dhe jojonik

- B)Osmolaritet të ulët dhe jonik
- C)Osmolaritet të lartë dhe jojonik
- D)Osmolaritet të lartë dhe jonik

2.Në projektionin MLO të gjirit, këndi i C - armit varion në vlerat:

- A)100 - 200
- B)300 - 600
- C)600 - 900
- D)Asnjëra

3.Për të vlerësuar refluksin vezikoureteral ka vlerë:

- A)Urografia intravenoze
- B)Cistouretrografia
- C)Ro- grafia e vezikes post miksionale
- D)Ro- grafia e thjeshtë

4.Nëse vihet re ajër i lirë peritoneal, atëherë kundraindikohe:

- A)Ekzaminimi me kontrast i ezofagut
- B)Ekzaminimi me kontrast i kolonit
- C)Ekzaminimi me kontrast i vezikes urinare
- D)Ekzaminimi me kontrast i uterusit

5.Në flebografinë e këmbës vendi ku bëhet injektimi, është:

- A)Në venën e kurrizit të këmbës
- B)Në venën e rrëzës së kofshës
- C)Në venën e pulpës së këmbës
- D)Asnjëra

6.Në urografinë intravenë, në minutën e 5-të ne presim të shohim kontrastimin e:

- A)Vezikes urinare
- B)Uretereve
- C)Kaliceve
- D)Asnjëra

7.Në pozicionin Trendelenburg, pacienti:

- A)Ka trupin të kthyer anash
- B)Koka më lart se këmbët
- C)Koka më poshtë se këmbët
- D)Qëndron përmbys

8.Projeksioni triklinar në U.I.V, zbatohet:

- A)Për të bërë diagnozën e trupave të lëvizshëm në vezike
- B)Për të anashkaluar kockat pelvike
- C)Për të vlerësuar refluksin urinar
- D)Për të vlerësuar strikturën e uretres

9.Histerosalpingografia ka vlerë në evidentimin e:

- A)Mukozes së uterusit
- B)Kalueshmerisë së tubave të Fallopit
- C)Ecurisë postoperatore në uterus
- D)Të gjitha

10.Për një patologji në zonën mediale të gjirit, projeksioni që jep informacion më të saktë, është

- A)LM
- B)MLO
- C)CC
- D)ML

11.Për kryerjen e ekzaminimit të TGI të sipërm me kontrast, kilovoltazhi varion në vlerat:

- A)70 -100 kv
- B)90 -120 kv
- C)120 - 150 kv
- D)70 -150 kv

12.Kur thuhet së do të përdoret ekzaminimi me dopio kontrast i stomakut, atëherë është përdorur:

- A)Barium i hollë + barium i trashë
- B)Barium + ujë
- C)Barium + ajër
- D)Asnjëra

13.Ekzaminimi i parë për kalkulozën e koledokut, është:

- A)Ro - grafia direkte e abdomenit
- B)Echo abdominale
- C)CT
- D)Rezonanca magnetike

14.Mosha kockore e fëmijës përcaktohet nëpërmjet:

- A)Ro-grafisë së dorës
- B)CT e kollonës
- C)MRI e dorës
- D)MRI e kollonës

15.Mosha kockore e fëmijës përcaktohet nga grafia e:

- A)Këmbës së djathtë
- B)Këmbës së majtë
- C)Dorës së djathtë
- D)Dorës së majtë

16.Për vendosjen e diagnozës së kifoze /skoliozës, bëhet:

- A)Ro-grafi e kollonës shtrirë
- B)Ro-grafi AP e kollonës në këmbë

- C)Ro-grafi LL e kollonës në këmbë
- D)Ro-grafi AP dhe Ro - grafi LL e kollonës në këmbë

17.Funksioni renal diagnostikohet, me:

- A)Shintigrafi renale
- B)Cistografi
- C)CT renale
- D)Ro-grafi të aparatit urinar

18.Ro-grafia e toraksit në pozicion supin, kryhet në:

- A)kontrollin e kateterit venoz qëndror
- B)versamentet pleurale
- C)Pneumotoraks
- D)pacientët e vjetër

19.Ekografia selektive e hapësirës retroperitoneale, jep informacion për:

- A)veshkat
- B)heparin
- C)stomakun
- D)kolecistën

20.Në angiografinë pulmonare, kontrasti lëshohet në:

- A)Arterien femorale dex
- B)Vena cava superior
- C)Arterien pulmonare
- D)V. Pulmonare

21.Ekografia mund të ndihmojë, në:

- A)Diagnostikimin e Pneumotoraksit
- B)Diagnostikimin e Atelektazës pulmonare
- C)Drenimin e versamenteve pleurale
- D)Diagnostikimin e patologjive hilare

22.Hiperplazia e timusit në radiografi, duket si:

- A)Ndryshim i konturit mediastinal
- B)Spontim i hapësirës ndërbrinjore
- C)Pamje nodulare në qafë
- D)Zonë e kalcifikuar

23.Nivelet hidroaerike në një grafi abdomeni, janë shenjë e:

- A)Okkluzionit intestinal
- B)Trupit të huaj në rektum
- C)Tumorit intestinal
- D)Artefakt

24.Veshka në formë patkoi, diagnostikohet me:

- A)Cistografi
- B)Urografi IV
- C)Cistografi dhe Urografi IV
- D)Asnjëra

25.Radiografia e dorës vizualizon:

- A)Kyçin e dorës dhe metakarpet
- B)Kyçin i dorës dhe gishtat
- C)Metakarpet dhe gishtat
- D)Metakarpet dhe karpet

26.Cili prej gishtave të dorës ka më pak artikulacione:

- A)I vogli
- B)I mesmi
- C)I madhi
- D)Treguesi

27.Radiografitë standarte të kollonës cervikale, janë:

- A)LL i majtë dhe LL i majtë
- B)AP dhe PA
- C)AP dhe LL
- D)AP dhe LL i djathtë

28.Parapërgatitja për urografinë, përfshin:

- A)Kryerjen e EKG
- B)Vlerësimi i vlerave të azotomisë dhe kreatinemisë
- C)Kryerjen e grafisë së pulmonit
- D)Ekografinë abdominale

29.Në dhomen e errët duhen evituar mbajtja e:

- A)Syzeve të diellit
- B)Vathëve dhe varëseve
- C)Celularëve
- D)Kutive të filmave

30.Për të studiuar një formacion në aksile, marrim me shumë informacion nga:

- A)Grafia e shpatullës
- B)Ekografia e sqetullës
- C)Arterografia e krahut
- D)Mamografia

31.Drita e kuqe në derën e jashtme të kabinetit të radiografisë, shërben për të:

- A)Treguar se kabineti është i zënë
- B)Përcaktuar radhën e ekzaminimit
- C)Treguar se ndodhesh në kabinet radiologjie
- D)Treguar se po kryhet një rrezatim, vetëm nëse është ndezur

32.Një kuti e filmave radiologjikë, zakonisht ka:

- A)50 filma
- B)100 filma
- C)150 filma
- D)200 filma

33.Thithja e rrezeve X, varet nga:

- A)Numri atomik i materialit
- B)Trashësia e materialit
- C)Gjatësia e valës së rrezatimit
- D)Madhësia e filmit

34.Dhoma e errët me zhvillues automatik, kërkon:

- A)Varëse për filmat e lagur
- B)Ambjent tharjeje
- C)Kaseta më të përparuara
- D)Më shumë kohë për tharjen e filmit

35.Është kusht që dhoma e errët të ketë:

- A)Dritare
- B)Pult komandimi
- C)Dollap për kasetat
- D)Dollap për rroba

36.Shenjuesi (R djathtas, L majtas) tregon:

- A)Anën e mbylljes së kasetës
- B)Anën e vendosjes së përforcuesit të imazhit
- C)Anën anatomike të pacientit
- D)Anën e futjes së tufës së rrezeve

37.Nga substancat e mëposhtme nuk konsiderohet lëndë kontrasti:

- A)Suspensionimi i sulgatit të bariumit
- B)Kripërat e argjendit
- C)Lëndët organike me përmbajtje të jodit
- D)Dioksidi i karbonit

38.Radiografia LL e qafës:

- A)Kryhet pavarësisht gjendjes së pacientit
- B)Është projekcioni komplementar i AP
- C)Kryhet vetëm LL e majtë
- D)Kryhet vetëm LL e djathtë

39.Meteorizem, do të thotë:

- A)Uje në hapësirën abdominale
- B)Uje në perikard

- C) Ajër në pleure
- D) Ajër në traktin gastrointestinal

40. Stativi është:

- A) Pjesë e dhomës së errët
- B) Pjesë e aparatit ku mbështetet pacienti
- C) Pjesë e pultit të komandës
- D) Të gjitha

41. Kutia e filmave, duhet:

- A) Të mbahet gjithmonë hapur
- B) Të hapet vetëm në fillim të punës
- C) Të mbahet horizontalisht
- D) Të mbahet vertikalisht

42. Skerma përforcuese:

- A) Mund të kapet dhe me duar
- B) Nuk dëmtohet nga drita
- C) Nuk skadon kurrë
- D) Duhet pastruar me ujë të vakët

43. Dimensionet e kasetës që do të përdoren, përcaktohen nga:

- A) Gjatësia e teknikut
- B) Lloji i ekzaminimit
- C) Lloji i kontrastit
- D) Të gjitha

44. Me projeksion, kuptojmë:

- A) Mënyrën e vendosjes së pacientit
- B) Drejtimin e rrezeve
- C) Mënyrën e vendosjes së kasetës
- D) Të gjitha

45. Kasetat vendoset në mënyrë të tillë, që:

- A) Mesi i saj të jetë në mes të trupit
- B) Mesi i saj të jetë në mes të organit që ekzaminohet
- C) Mesi i saj të jetë në mes të stativit
- D) Të gjitha

46. Drita e bardhë e dhomës së errët, mund të hapet:

- A) Në çdo kohë
- B) Vetëm nëse trokasin në derë
- C) Vetëm pasi sigurohemi që pakoja e filmave është mbyllur me kapak
- D) Asnjëherë

47. Cili nga të mëposhtmit, nuk është projeksion:

- A)Sagital
- B)Aksial
- C)Oblik
- D)Horizontal

48.Cili nga të mëposhtmit, nuk është plan:

- A)Sagital
- B)Frontal
- C)Horizontal
- D)Tangencial

49.Për grafinë e dhëmbit në nofullën e sipërme, filmi:

- A)Mbahet me gishtin e madh të dorës së njëjtë
- B)Mbahet me gishtin e madh të dorës së kundërt
- C)Mbahet me gishtin tregues të dorës së njëjtë
- D)Mbahet me gishtin tregues të dorës së kundërt

50.Grafia e këmbës së shëndoshë, bëhet:

- A)Për qëllime studimi
- B)Për të krahasuar me anën e sëmurë
- C)Në rast frakture të anës së sëmurë
- D)Për të eliminuar artefaktet

51.Ipsilateral do të thotë:

- A)Nga ana e kundërt
- B)Nga ana e njëjtë
- C)Nga i njëti pozicion
- D)Nga pozicioni i kundërt

52.Për radiografinë e dhëmbëve të nofullës së poshtme, filmi:

- A)Mbahet me gishtin e madh të dorës së njëjtë
- B)Mbahet me gishtin e madh të dorës së kundërt
- C)Mbahet me gishtin tregues të dorës së njëjtë
- D)Mbahet me gishtin tregues të dorës së kundërt

53.Radiografia e abdomenit është ekzaminimi i parë i zgjedhur, në rast të:

- A)Traumës së mbyllur të abdomenit
- B)Kalkulozës së kolecistës
- C)Ulcerës gastrike
- D)Klakuozës renale

54.Likidi i lirë abdominal, diagnostikohet me:

- A)Ro-grafi abdomeni A-P
- B)Ro-grafi abdomeni L-L
- C)Ro-grafi abdomeni shtrirë supin
- D)Ro-grafi abdomeni shtrirë pronë



55.Cili është kundraindikacioni për kryerjen e Histerosalpingografisë:

- A)Pacientja në periudhe të ovulacionit
- B)Pacientja nuk qëndron dot shtrirë
- C)Pacientja ka kryer një intervent në tubat e fallopit
- D)Pacientja ka kryer një intervent në uterus

56.Në radiografinë e traumës së abdomenit, cilën pjesë të trupit të femrës duhet të mbulojmë me përparëse plumbi:

- A)Gjendrat tiroide
- B)Gjendrat e gjirit
- C)Toraksin
- D)Organet genitale

57.Radiacioni me energji të lartë, do të ketë më shumë:

- A)Shpejtësi
- B)Intensitet
- C>Fuqi penetruese
- D)Intensitet dhe fuqi penetruese

58.Në projeksionin MLO:

- A)Kaseta vendoset pingul me m.pectoral
- B)Kaseta vendoset paralel me m.pectoral
- C)Kaseta vendoset pingul dhe paralel me m.pectoral
- D)Asnjëra

59.Shenjuesi në mamografi lokalizohet, në:

- A)Superointern
- B)Superoekstern
- C>Inferointer
- D>Inferoekstern

60.Rrezja në projeksionin MLO, orientohet:

- A)Ekstern - intern
- B)Superointern - inferoekstern
- C)Postëroekstern - superointern
- D)Asnjëra

61.Këndi i C- armit në MLO, është:

- A)30 gradë
- B)45 gradë
- C)60 gradë
- D)90 gradë

62.Kompresioni në kryerjen e mamografisë është i rëndësishem, sepse:

- A)Redukton rrezatimin përhapës

- B) Redukton ekspozimin me rreze X
- C) Redukton rrezatimin përhapës dhe ekspozimin me rreze X
- D) Asnjëra

63. Gjiri dens, ka nevojë për:

- A) Kv me të lartë
- B) Kv me të ulët
- C) Kompresim më të fortë
- D) Asnjëra

64. Kur një atom shkon drejt dekompozimit spontan, ai mund të çlirojë:

- A) Elektrone
- B) Protone
- C) Neutrone
- D) Të gjitha

65. Mutacioni si pasojë e rrezatimit, ndodh nga prekja e:

- A) Membranës qelizore
- B) Murit të qelizës
- C) ADN
- D) ARN

66. Doza kumulative e rrezatimit tek njeriu:

- A) Merret që gjatë lindjes
- B) Zhdukët me kohën
- C) Nuk zhdukët asnjëherë
- D) Është rrezatim i padëmshëm

67. Tipet e qelizave me të ndjeshme nga rrezatimi janë:

- A) Ato që ndahen më shpejt
- B) Ato që ndahen më ngadalë
- C) Ato që ndodhen në lëkurë
- D) Të gjitha

68. Efekt somatik i vonshëm nga rrezatimi, është:

- A) Skuqja e lëkurës
- B) Kanceri
- C) Të vjellat
- D) Nuk ka të tilla

69. Kur distanca nga burimi i rrezatimit dyfishohet, sasia e rrezatimit të marrë do të jetë:

- A) Dyfish
- B) Katërfish
- C) Zvogëlohet me 1/2
- D) Zvogëlohet me 1/4

70.Një simptom i mbiexpozimit nga rrezatimi i cili ndodh vonë në kohë, quhet:

- A)Efekt sonatik
- B)Efekt biologjik
- C)Efekt latent
- D)Efekt gjenealogjik

71.Sa rrezatim duhet të marrë në vit një teknik rentgeni:

- A)15 rem
- B)10 rem
- C)50 rem
- D)5 rem

72.Fletët e kolimatorit përbëhen nga:

- A)Plumbi
- B)Alumini
- C)Bakri
- D)Asnjëra

73.Pjesët dense të trupit, në radiografi duken:

- A)Gri
- B)Të zeza
- C)Të bardha
- D)Kafe

74.Cilësia e tufës së rrezeve -X, varet direkt nga:

- A)Piku i tensionit që aplikohet në tub
- B)Lloji i kurbës së tensionit që aplikohet në tub
- C>Filtrimi total i rrezeve
- D)Të gjitha

75.Një piksel, është:

- A)Element volumi
- B)Element figure
- C)Imazh në miniaturë
- D)Asnjëra

76.Cila nga metodat është më e mira në reduktimin e lëvizjeve respiratore në ct:

- A)Reduktimi i kohës së skanimit
- B)Komunikimi i mirë me pacientin
- C>Përdorimi i pajisjeve imobilizuese
- D)Administrimi i glukagonit

77.Aftësinë e skanerit për të diferencuar objekte me koeficient të mbajtjes afërsisht të njëjtë, e përshkruan:

- A)Rezolucioni spacial
- B)Rezolucioni i kontrastit

- C)Lineariteti
- D)Modulimi

78.Malleoli lateral, ndodhet në:

- A)Gju
- B)Shpatull
- C)Kyçin e këmbës
- D)Kyçin e dorës

79.Për të rritur thellësinë e penetrimit të sondës ekografike, duhet të:

- A)Rrisim frekuencën
- B)Ulim frekuencën
- C)Rrisim shpejtësinë
- D)Ulim amplitudën

80.Për projeksionin PA oblik te foramen optike, rrezja qendrore duhet të drejtohet:

- A)Paralel me linjën interpupilare
- B)Pingul me linjën interpupilare
- C)Paralel me linjën akantomeatale
- D)Paralel me linjën glabellomeatale

81.Cila prej substancave thith me shumë rreze X:

- A)Muskuli
- B)Dhjami
- C)Ajri
- D)Kocka

82.Krahasuar me indin normal të gjendrës së gjirit, densiteti radiografik i një gjiri të rrezatuar është:

- A)Radiolucent
- B)Me shumë dens
- C)Me pak dens
- D)Me densitet të njëjtë

83.Për grilën, nuk është e vërtetë që:

- A)Përmirëson kontrastin radiografik
- B)Redukton rrezatimin përhapës
- C)Përdoret në rutinë për procedurat me kvp të ulët
- D)Nuk përdoret në asnjë procedurë

84.Është në proporcion të zhdrejtë me kvp:

- A)Densiteti radiografik
- B)Kontrasti radiografik
- C)Rezolucioni
- D)Shtrembërimi

85.Mund të kontrollohet nga radiografi:

- A)Densiteti radiografik
- B)Kontrasti radiografik
- C)Densiteti radiografik dhe kontrasti radiografik
- D)Asnjëra

86.Si varojnë vlerat e kvp në mamografi:

- A)20 - 25 kvp
- B)30 - 35 kvp
- C)25 - 40 kvp
- D)35 - 50 kvp

87.Nuk konsiderohet artefakt që ndodh në imazhin ekografik:

- A)Trashësia e skanimit
- B)Demostrimi i përforcimit posterior
- C)Prodhimi i hijes akustike
- D)Skanimi i zonës së gabuar

88.Cila kockë është përballë radiusit:

- A)Humerusi
- B)Ulna
- C)Skafoid
- D)Tibia

89.Dimensionet e filmit për radiografinë pulmonare të një adulti, janë:

- A)18 x 24 cm
- B)24 x 24 cm
- C)30 x 40 cm
- D)Asnjëra

90.Mjekësia nukleare, vlerëson:

- A)Anatominë e një strukture
- B)Morfologjinë e një strukture
- C)Funksionin e një strukture
- D)Të gjitha

91.Para kryerjes së aortografisë, është i nevojshëm:

- A)Lavazhi intestinal
- B)Sedacioni i zonës së punkcionit
- C)Pacienti të jetë në gjumë
- D)S`ka nevojë për përgatitje

92.Kundraindikacion absolut për kryerjen e radiografisë së kollonës cervikale, është:

- A)Pacienti nuk qëndron dot në këmbë
- B)Ka bërë më parë një ekzaminim me kontrast
- C)Është shtatzënë

D)Ka qafë shumë të shkurtër

93.Pamja radiografike e gjirit mund të ndikohet nga:

- A)numri i lindjeve
- B)gjendja hormonale
- C)marrja e acidit askorbik
- D)numri i mamografive të mëparshme

94.Spina scapula, është në anën:

- A)laterale të scapules
- B)mediale të scapules
- C)inferiore të scapules
- D)posterire të scapules

95.Cila nga këto struktura nuk gjendet në ulne:

- A)procesi stiloid
- B)koka
- C)procesi olecranon
- D)capitulum

96.Fossa olecranon, ndodhet në:

- A)radius
- B)ulna
- C)scaphoid
- D)asnjëra

97.Cila strukturë nuk gjendet në radius:

- A)koka
- B)procesi styloid
- C)tuberoziteti
- D)epikondili lateral

98.Cilat kocka kraniale janë dyshe:

- A)etmoidale
- B)parietale
- C)temporale
- D)parietale dhe temporale

99.Rrezja qëndrore hyn 5 cm mbi meatusin akustik estern, në:

- A)Projeksionin lateral të kokës
- B)Metodën Caldwell
- C)Metodën Townes
- D)Projeksionin AP

100.Cila strukturë nuk është pjesë e kockës sfenoide:

- A)Fletët e mëdha

- B)Sella turcika
- C)Clivuc
- D)Crista galli

101.Cila prej strukturave nuk është pjesë e kockave kraniale:

- A)sfenoidale
- B)etmoidale
- C)frontale
- D)vomer

102.Dora duhet mbledhur grusht në:

- A)Projeksionin PA të dorës
- B)Projeksionin lateral të dorës
- C)Projeksionin PA të kyçit
- D)Asnjëra

103.Peritoneumi është një membranë e lokalizuar në kavitetin:

- A)kranial
- B)torakal
- C)mediastinal
- D)abdominal

104.Kontrasti për urografinë intravenoze, llogaritet:

- A)Në bazë të patologjisë së vezikës
- B)Për kg/peshe
- C)Në bazë të seksit
- D)Në bazë të kohës së ekzaminimit

105.Kockat e kyçit, njihen si:

- A)falange
- B)tarse
- C)metatarse
- D)karpe

106.Kocka e kyçit më proksimale, është:

- A)lunate
- B)capitate
- C)trapazoid
- D)trapezium

107.Nuk është kockë faciale:

- A)vomer
- B)etmoidale
- C)lakrimale
- D)maksilare

108.Për pozicionin lateral të kockave faciale është e vërtetë që:

- A)RQ është 5 cm mbi meatus akustik ekstern
- B)Linja interorbitomeatale është paralel me aksin e kasetës
- C)Linja interpupilare paralel me kasetën
- D)Të gjitha

109.Projektioni tangencial përdoret për të evidentuar:

- A)kockat nazale
- B)zygomat
- C)orbitat
- D)të gjitha

110.Struktura më proksimale është:

- A)Koka e femurit
- B)Gjuri
- C)Kyçi i këmbës
- D)Gishti i këmbës

111.Nëse skerma skadon:

- A)I rriten dimensionet e kokrrizave
- B)I ulen dimensionet e kokrrizave
- C)I humbet fluoreshenca
- D)I rritet fluoreshenca

112.Përgatitja e pacientit për ekzaminim me kontrast të traktit gastrointestinal bëhet:

- A)2 orë esëll me klizmë
- B)4 orë esëll pa klizmë
- C)6 orë esëll pa klizmë
- D)8 orë esëll me klizmë

113.Roli i dhomës së errët është:

- A)Ajrosja e kabinetit të radiologjisë
- B)Akomodimi i syrit
- C)Mbushja dhe zbrazja e kasetave të filmit
- D)Si garderobë për personelin

114.Kurbatura e madhe është pjesë e:

- A)Zorrës së trashë
- B)Duodenit
- C)Stomakut
- D)Ezofagut

115.Cila nga këto kocka faciale nuk është çift:

- A)vomer
- B)zygomatike
- C)lakrimale



D)palatine

116.Në frakturën e kokës proksimale të radiusit Ro-grafia duhet të përfshijë edhe:

- A)Kokën distale të tij
- B)Humerusin
- C)Kokën proksimale të ulnës
- D)Kokën distale të ulnës

117.Cila nga projeksionet e tregon procesin koronoid pa superpozime:

- A)AP e bërrylit
- B)Medial oblik i bërrylit
- C)Lateral oblik i bërrylit
- D)AP e parakrahut

118.Cila nga këto struktura lokalizohet medialisht në projeksionin AP të bërrylit:

- A)Capitulum
- B)Troklea
- C)Koka e radiusit
- D)Troklea dhe koka e radiusit

119.Element i domosdoshëm në ekzaminimin me kontrast të zorrës së trashë është:

- A)Pacienti të ketë një shoqërues
- B)Kabineti të ketë fluoroskopi televizive
- C)Të jetë i ospitalizuar (shtruar) paraprakisht
- D)Dhoma të ketë temperaturë 25 gradë celcius

120.Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon në ndërprerjen e grilës:

- A)Tubi jashtë qendrës
- B)Tubi i rrezeve është pingul me fletët e grilës
- C)Distanca e pasaktë mes trupit dhe kasetës
- D)Grila fillon të lëvizë para se të fillojë ekspozimi

121.Në distancën prej 50 cm ekspozohemi me 200 mr. Si do të jetë ekspozimi në 100 cm:

- A)16 mr
- B)50 mr
- C)400 mr
- D)800 mr

122.Lokalizimi i rrezes qendrore në projeksionin Townes është:

- A)3.8 cm mbi glabelle
- B)5 cm mbi glabelle
- C)6.3 cm nën glabelle
- D)6.3 cm mbi glabelle

123.Cila është kocka më e vogël e kyçit:

- A)lunate

- B)hamate
- C)pisiform
- D)scaphoid

124.Numri i kockave të dorës është:

- A)25
- B)27
- C)33
- D)22

125.Cila kockë është në focus në projeksionin PA me devijim ulnar të kyçit:

- A)Lunate
- B)Scaphoid
- C)Pisiform
- D)Capitate

126.Numri i kockave të kyçit të dorës është:

- A)6
- B)22
- C)8
- D)10

127.Për metoden WATER të kokës, koka e pacientit anohet me:

- A)30 gradë
- B)35 gradë
- C)37 gradë
- D)53 gradë

128.Metoda WATER njihet gjithashtu dhe si projeksioni:

- A)parietoacanthial
- B)parietomental
- C)parietoglabellar
- D)parietonasal

129.Në telarentgenografi distanca burim rrezatimi kasetë, është:

- A)80 cm
- B)100 cm
- C)150 cm
- D)180 cm

130.Pikat orientuese për radiografinë e bacinit janë:

- A)Umbilikusi
- B)Dy kristat iliake anterior superior
- C)Simfiza pubike
- D)Kokat e femurit

131.Në projeksionin OAD pacienti pozicionohet:

- A)45 gradë i rrotulluar djathtas
- B)90 gradë i rrotulluar djathtas
- C)45 gradë i rrotulluar majtas
- D)89 gradë i rrotulluar majtas

132.Defekografia gjen indikacion në vlerësimin e:

- A)Çrregullimeve të urinimit
- B)Çrregullimeve të jashtëqitjes
- C)Çrregullimeve të tretjes
- D)Çrregullimeve të gëlltitjes

133.Ekzaminimi i zgjedhur për zorrën e trashë, është:

- A)Ekografia
- B)Grafia direkte
- C)Grafia me kontrast
- D)Grafia pa kontrast

134.Efekti dëmtues i rrezatimit ulet, nëse:

- A)Kryejmë më pak ekzaminime
- B)Nuk lëvizim
- C)Rrisim distancën nga burimi i rrezeve
- D)Pijmë më shumë qumësht

135.Skerma përforcuese është pjesë e:

- A)Zvilupatrices
- B)Kasetës së filmit
- C)Tubit të rrezeve
- D)Pultit të komandimit

136.Fazat e urografisë janë:

- A)Cistografike + nefrograma +kalicopielike
- B)Nefrograma + kalicopielike + cistografike
- C)Kalicopielike + nefrograma + cistografike
- D)Cistografike + kalicopielike + nefrograma

137.Olekranon është strukturë e:

- A)Humerusit
- B)Ulnës
- C)Radiusit
- D)Asnjëra

138.Roli i filtrit është:

- A)Të japë rrezatim të dobishëm
- B)Të reduktojë fushën e rrezatimit
- C)Të ndalojë rrezet e buta

D)Asnjëra

139.Rrezja qëndrore quhet:

- A)Rrezja që bie në qendër të trupit
- B)Rrezja që prodhohet në qendër të katodës
- C)Rrezja që ndodhet në mes të tufës së rrezeve X
- D)Të gjitha

140.Koha e ekspozimit shkurtohet:

- A)Duke kryer më shumë grafi
- B)Duke mos përdorur skermat
- C)Duke përdorur filma me emulsion të dyfishtë
- D)Duke përdorur filma me ndjeshmeri të lartë

141.Sialografia studion patologjitë e:

- A)Gjendrës sublinguale
- B)Gjendrës parotis
- C)Gjendrës submandibulare
- D)Të gjitha

142.Rrezet sekondare mund të rriten nëse:

- A)ulet distanca vatër - objekt
- B)përdorim diafragmë
- C)përdorim filtra
- D)përdorim grila

143.Cili gabim duhet evituar në radiografi dentare:

- A)Drejtimi i rrezes qendrore
- B)Mbajtja e gabuar
- C)Vendosja gabim e emrit
- D)Gabim në larje

144.Seriografi nënkupton:

- A)Realizim të radiografisë nën kontrollin radiografik
- B)Realizim të radiografisë njëra pas tjetrës të një strukture
- C)Realizim të radiografisë me distancë të lartë
- D)Regjistrim të radiografisë në një film

145.Projeksioni oblik kaudal është rreze që hyn:

- A)Pjerrët në drejtim të kokës
- B)Pjerrët në drejtim të këmbës
- C)Pjerrët në drejtim majtas
- D)Pjerrët në drejtim djathtas

146.Ekzaminimi i ezofagut me tabletën me barium ka vlerë në diagnostikimin e:

- A)Tumorit të ezofagut

- B)Strikturës së ezofagut
- C)Refluksit gastroezogageal
- D)Ulcerës ezofageale

147.Në projeksionin lateral të kokës rrezja qëndrore centrohet:

- A)5 cm mbi meatusin akustik ekstern
- B)Në këndin e mandibulës
- C)5 cm mbi këndin e mandibulës
- D)Në këndin e syrit

148.Rrotullimi i kokës, ndodh kur:

- A)Plani koronal nuk është paralel me filmin
- B)Plani medial sagital nuk është paralel me filmin
- C)Plani aksial nuk është paralel me filmin
- D)Plani oblik nuk është paralel me filmin

149.Linja vertebrale posteriore është:

- A)Buza posteriore e trupave të vertebrale
- B)Kufiri posterior i kanalit spinal
- C)Majat e proceseve spinoze
- D)Kufiri posterior i kanalit spinal dhe majat e proceseve spinoze

150.Projeksioni odontoid realizohet me kushtet e mëposhtme:

- A)Pacienti me gojë hapur, me rreze qendrore pingul me kasetën
- B)Pacienti me gojë hapur, në pozicion lateral me rrezen qendrore pingul me densin
- C)Pacienti me gojë hapur, me rrezen qendrorë me kënd 20 gradë cranial
- D)Pacienti me gojë hapur, në pozicion lateral, me rrezen qendrore 20 gradë kaudal me kasetën

151.Në ro-grafinë AP të kollonës lumbare, është kusht i domosdoshëm:

- A)Centrimi i rrezes qendrore në L2
- B)Evidentimi i distancës nga T10 deri në koksigeus
- C)Centrimi i rrezes qendrore me kënd kaudal
- D)Evidentimi i vertebrale lumbare nga L1 në L5

152.Roli i grilës është:

- A)Thithja e rrezatimit përhapës
- B)Kufizimi i përhapjes së tufës së rrezeve X
- C)Ulja e intensitetit të rrezeve X
- D)Rritja e kilovotazhit të rrezeve X

153.Roli i diafragmës është:

- A)Thithja e rrezatimit përhapës
- B)Kufizimin e përhapjes së tufës së rrezeve X
- C)Uljen e intensitetit të rrezeve X
- D)Rritjen e kilovotazhit të rrezeve X

154. Për kryerjen e koronarografisë punkcioni për injektimin e kontrastit bëhet në:

- A) Arterien koronare
- B) Aortën torakale
- C) Arterien femorale dexter
- D) Arterien karotide dexter

155. Akalazia evidentohet nëpërmjet:

- A) Ro-grafisë së thjeshtë
- B) Ro-grafisë me kontrast të Traktit gastrointestinal
- C) CT me kontrast intravenë
- D) Rezonancë magnetike

156. Nëse në radiografinë AP të kolonës lumbare shihet një fisurë vertikale në nivel të harqeve posteriorë të L5, patologjia e dyshuar mund të jetë:

- A) Hernia diskale
- B) Spina bifida
- C) Artriti reumatoid
- D) Të gjithë

157. Vlerat e kv në radiografinë abdominale në këmbë, variojnë në vlerat e mëposhtme:

- A) 110 - 125 kv
- B) 90 - 100 kv
- C) 80 - 90 kv
- D) 70 - 80 kv

158. Vlerat e kv në radiografinë AP të pelvisit, variojnë në vlerat e mëposhtme:

- A) 110 - 125 kv
- B) 90 - 100 kv
- C) 80 - 90 kv
- D) 120 - 130 kv

159. Vlerat e kv në radiografinë laterale të toraksit, variojnë në vlerat e mëposhtme:

- A) 120 - 130 kv
- B) 110 - 125 kv
- C) 90 - 100 kv
- D) 80 - 90 kv

160. Nëse radionuklidi ka gjysëm jete 14 ditë, sa do të mbetet pas 8 javësh:

- A) 16-Jan
- B) 08-Jan
- C) Jan-32
- D) 04-Jan

161. Në projektionin fronto oksipital 30 gradë të kokës, rrezja qendrore centrohet:

- A) 3 cm mbi radix nasi
- B) 5 cm mbi radix nasi

- C)6 cm mbi radix nasi
- D)2 cm mbi radix nasi

162.Për ekzaminimin e ezofagut:

- A)Pacienti duhet të ketë kryer më parë Skanerin
- B)Studimi mund të kryhet dhe pa kontrast
- C)Grafia direkte jep shumë informacion
- D)Kërkohe kontrast më i hollë se ai që përdoret për stomakun

163.Rezolucioni i kontrastit është:

- A)Aftësia të dallojë 2 pika të afërta të imazhit me kontrast të ndryshëm indor
- B)Aftësia të dallojë 2 pika të largëta të imazhit me kontrast të ndryshëm indor
- C)Aftësia të dallojë 2 pika të afërta të imazhit me kontrast të njëjtë indor
- D)Aftësia të dallojë 2 pika të largëta të imazhit me kontrast të njëjtë indor

164.Efekti doppler përdoret në:

- A)Grafii direkte
- B)Urografi
- C)Histerosalpingografi
- D)Ekografi

165.Më shumë rrezatim përhapës, formohet nga:

- A)Filmi
- B)Tubi i rrezeve
- C)Kaseta
- D)Pacienti

166.Zhvendosja e një vertebre para një tjetre që ndodh zakonisht në L5 - S1, quhet:

- A)Spondilitis
- B)Spondilolistezis
- C)Osteoartritis
- D)Spondilit ankilozant

167.Kur pacienti vjen në kabinet me qesen e kateterit urinar Foley, është e rëndësishme:

- A)Të vendoset qesja e drenimit mbi nivelin e vezikës
- B)Të vendoset qesja e drenimit në nivelin me vezikën
- C)Të vendoset qesja e drenimit nën nivelin me vezikën
- D)Të mbyllet kateteri

168.Nëse pacienti ankon për dhimbje të metakarpeve të katërt dhe të pestë të dorës së majtë dhe është kerkuar radiografi e parakrahut të majtë, atëherë:

- A)Kryhet grafii e dorës së majtë
- B)Kryhet grafii e parakrahut të majtë
- C)Kryhet grafii e parakrahut dhe dorës së majtë
- D)Konsultohemi me mjekun

169.Skanograma është:

- A)Imazh udhëheqës në radiografi
- B)Imazh udhëheqës në ekografi
- C)Imazh udhëheqës në CT
- D)Imazh udhëheqës në MRI

170.Rritja e distancës objekt - film, do të japë:

- A)Rritje të dozës rrezatuese për pacientin
- B)Nevojën për uljen e mas
- C)Rritjen e zmadhimit
- D)Uljen e turbullirës gjeometrike

171.Për studimin e patologjive të ureterit, kryhet:

- A)Cistografia
- B)Ekografia
- C)Urografia
- D)Grafia direkte

172.Ekzaminimi i parë i testeve, është:

- A)Grafia direkte
- B)Grafia me kontrast IV
- C)Skneri
- D)Eko doppler

173.Në shintigrafinë kockore, kontrasti injektohet:

- A)Në kockën në studim
- B)Subkutan pranë kockës në studim
- C)Endovenoz
- D)Endoarterial

174.Kockat më pranë kyçit të dorës, janë:

- A)Trapezi + trapezium
- B)Skafoide + trapezoidum
- C)Kapitati + trapezium
- D)Lunatë + skafoide

175.Në projeksionin PA të kyçit të këmbës, maleoli medial nuk duhet të vendoset mbi talus.

Nëse kjo ndodh, ne duhet të:

- A)Bëjmë imobilizim më të mirë
- B)Rregullojmë rotacionin e këmbës
- C)Rrisim dorsi fleksionin e këmbës
- D)Ndryshojmë drejtimin dhe këndin e rrezes qendrore

176.Termi ventral është sinonim i Termit:

- A)Posterior
- B)Lateral



- C)Kaudal
- D)Anterior

177.Nuk bën pjesë në nukleusin e një atomi:

- A)një neutron
- B)një proton
- C)një pozitron
- D)një foton
- E)një elektron

178.I sëmuri mund të largohet nga kabineti:

- A)pasi sigurohemi që është mirë me shëndet
- B)pasi sigurohemi që ka një shoqërues
- C)pasi sigurohemi që ka paguar ekzaminimin
- D)pasi sigurohemi që grafia ka dalë mirë

179.Radioaktiviteti:

- A)Një numër fiks atomesh zbërthehen në njësinë e kohës (-)
- B)Gjysmë jeta efektive është gjithmonë më e shkurtër se sa gjysmë jeta biologjike ose fizike
- C)Energjia është karakteristike për radionuklidin
- D)Jodi - 131 emeton pjesëza beta

180.Rrezatimi në dalje (i matur në hyrje të sipërfaqes së trupit të pacientit) nga tubi i rrezeve -X, rritet me:

- A)rritjen e kilovoltazhit
- B)rritjen e lëvizjes brenda tubit
- C)rritjes së nr atomik të targetit
- D)rritjen e distancës me pacientin (-)

#### **4. Radiografia e dorës, këmbës, kolonës, kockave dhe vertebrave**

1.Ku centrohet rrezja qendrore, për projeksionin PA të dorës:

- A)Në mes të karpeve
- B)Në bazën e metakarpit të tretë
- C)Në artikulacionin metakarpofalangeal të tretë
- D)Në artikulacionin interfalangeal proksimal të gishtit të tretë

2.Duke filluar nga pozicioni pronë, sa gradë duhet të rrotullohet dora për të përfutur projeksionin PA oblik të dorës:

- A)15
- B)25
- C)35
- D)45

3.Cila manovër në pozicionimin e kyçit të dorës, hap hapësirën interkarpale në grafinë laterale të dorës:

- A)Hiperfleksioni
- B)Hiperekstensioni
- C)Devijimi ulnar
- D)Devijimi radial

4.Cili projektion i kyçit, korrigjon shkurtimin e kockës skafoide:

- A)PA
- B)Lateral
- C)PA me devijim ulnar
- D)PA me devijim radial

5.Në cilin projektion të kyçit të dorës, procesi styloid radial është i mbivendosur mbi procesin stiloid ulnar:

- A)PA
- B)Lateral
- C)PA oblik
- D)PA aksial

6.Si duhet të pozicionohet dora dhe kyçi, për të përfutur projektionin PA oblik të kyçit të dorës:

- A)Dora në pronacion, rrotullohet kyçi me pjesën ulnare lart
- B)Dora në pronacion, rrotullohet kyçi me pjesën radiale lart
- C)Dora në supinacion, rrotullohet kyçi me pjesën lunare lart
- D)Dora në supinacion, rrotullohet kyçi me pjesën radiale lart

7.Cili projektion i kyçit, tregon më mirë konikën skafoide dhe artikulacionet që lidhen me të:

- A)Projektioni lateral
- B)Projektioni inferosuperior
- C)Projektioni me devijim ulnar
- D)Projektioni me devijim radial

8.Cili është pozicioni i dorës në radiografinë AP të parakrahut për të evituar mbivendosjen radiale:

- A)Pronacioni i dorës
- B)Supinacioni i dorës
- C)Plani koronal i epikondileve të humerusit paralel me kasetën
- D)Plani koronal i epikondileve të humerusit pingul me kasetën

9.Në cilin projektion të parakrahut, duhet që bërryli të përthyhet me 90 gradë:

- A)AP
- B)Lateral
- C)AP oblik medial
- D)AP oblik lateral

10.Cili projektion i bërrylit tregon kokën radiale pa superpozime:

- A)AP
- B)Lateral

- C)AP oblik lateral
- D)AP oblik medial

11.Si duhet të pozicionohet plani koronal i epikondileve të humerusit në krahasim me kasetën, për të përfutur projeksionin lateral të bërrylit:

- A)Paralel
- B)Pingul
- C)45 gradë rrotullim lateral
- D)45 gradë rrotullim medial

12.Cili projeksion i ekstremitetit superior, tregon më mirë kokën radiale pa superpozime:

- A)AP oblik lateral i kyçit
- B)PA oblik medial i kyçit
- C)AP oblik lateral i bërrylit
- D)AP oblik medial i bërrylit

13.Në cilin projeksion oblik të ekstremitetit superior, duket koka e radiusit e mbivendosur mbi ulnën:

- A)AP oblik lateral i kyçit
- B)PA oblik medial i kyçit
- C)AP oblik lateral i bërrylit
- D)AP oblik medial i bërrylit

14.Në cilin projeksion të bërrylit, tregohet më mirë olekranoni në profil:

- A)AP
- B)Lateral
- C)AP oblik lateral
- D)AP oblik medial

15.Cili projeksion i bërrylit tregon olekranonin në fossa olekrane dhe procesin koronoid në profil:

- A)AP
- B)Lateral
- C)AP oblik lateral
- D)AP oblik medial

16.Kur realizohet projeksioni AP i humerusit, cili element tregon saktësinë e kryerjes së radiografisë:

- A)Centrimi i rrezes qendrore
- B)Pozicionimi i epikondileve
- C)Pozicionimi i kasetës
- D)Vizualizimi i tuberkulit të vogël në profil

17.Cili kriter vlerësues tregon se, humerusi është pozicionuar korrekt për projeksionin AP:

- A)Epikondilet janë të mbivendosur
- B)Tuberkuli i vogël duket në profil

- C)Tuberkuli i madh është i vendosur mbi kokën e humerusit
- D)Koka humorale dhe tuberkuli i madh duken në profil

18.Duke ju referuar kasetës, si përcaktohet nëse humerusi është i vendosur korrekt për pozicionin lateral të tij:

- A)Dora është në pronacion
- B)Dora është vendosur në pozicion korrekt lateral
- C)Plani koronal i epokondileve humorale është paralel
77.Për projektionin AP axial të artikulacionit temporomandibular, ku duhet të drejtohet rrezja qendrore:

- A)nasion
- B)glabela
- C)axantion
- D)7.6 cm mbi nasion

78.Duke iu referuar pacientit, ku duhet të centrohet kasetja për projektionin axiolateral oblik të artikulacionit temporomandibular:

- A)në glabele
- B)1.2 cm anteriorisht meatusit akustik ekstern
- C)2.5 cm posterior meatusit akustik ekstern

D)5 cm mbi meatusit akustik ekstern

79.Cila strukture duhet të radiografohet, duke e patur pacientin gjithnjë në pozicionin vertikal:

- A)orbitat
- B)mastoidet
- C)harqet zygomatike
- D)sinuset paranazale

80.Cila nga të mëposhtmit është projeksioni i vetëm për sinuset paranazale, që tregon në mënyrë të plotë të katërt grupet e sinuseve:

- A)lateral
- B)sybmentovertikal
- C)PA axial, metoda Caldwell
- D)parietoacantial, metoda Waters

81.Duke iu referuar cantusit të jashtëm, ku duhet të drejtohet rrezja qendrore për projeksionin lateral të sinusit:

- A)inferior
- B)superior
- C)anterior
- D)posterior

82.Cili grup i sinuseve është i rëndësisë së parë, në projeksionin lateral të sinuseve:

- A)frontal
- B)maxilar
- C)etmoidal
- D)sfenoidal

83.Cili grup i sinuseve tregohet më mirë në projeksionin PA axial, metoda Caldwell:

- A)frontali dhe sfenoidali
- B)frontali dhe etnoidali anterior
- C)maxilari dhe sfenoidali
- D)maxilari dhe etmoidali anterior

84.Për projeksionin PA, metoda Caldwell e sinuseve, cila linjë pozicioni në lidhje me planin midsagital ,duhet të jetë perpendikulare me kasetën:

- A)orbitomatal
- B)interpupilar
- C)glabelomeatal
- D)infraorbitomeatal

85.Ku duhet të shihet crista petroze në imazhin e përftuar nga projeksioni PA axial, metoda Caldwell e sinuseve:

- A)superior orbitave
- B)një e treta e poshtme e orbitave
- C)përmes sinuseve maxilare

D)nën sinuset maxilare

86.Cila linjë pozicioni duhet të formojë një kënd 37 gradë me kasetën për projeksionin parietoacantial, metoda Waters:

- A)orbitomeatal
- B)glabelomeatal
- C)acantiomeatal
- D)infraorbitomeatal

87.Duke iu referuar kasetës, si duhet të drejtohet rrezja qendrore për projeksionin Parietoacantial, metoda Waters:

- A)pendikular
- B)15 gradë kaudad
- C)23 gradë kaudad
- D)37 gradë kaduad

88.Cili grup i sinusve paranazale tregohet më mirë në projeksionin parietoacantial, metoda Waters:

- A)frontal
- B)maxilar
- C)etmoidal
- D)sfenoidal

89.Ku duhet të shihet crista petroze në imazhin e përftuar nga projeksioni parietoacantial, metoda Waters e sinuseve paranazale:

- A)superior orbitave
- B)në një të tretën e poshtme të orbitave
- C)përmes sinuseve maxilare
- D)nën sinuset maxilare

90.Në projeksionin parietoacantial, metoda Waters, në cilën strukturë duhet të dalë rrezja qendrore:

- A)nasion
- B)glabella
- C)acantion
- D)pika mentale

91.Cili grup i sinusve paranazale, nuk tregohet më mirë në imazhin e përftuar nga projeksioni parietoacantial, metoda Waters:

- A)frontal
- B)maxilar
- C)etmoidal
- D)sfenoidal

92.Cili prej dy grupeve të sinuseve paranazale, tregohet më mirë në projeksionin Submentovertikal, krahasuar me sinuset e tjera:

- A)forntal dhe maxilar
- B)frontal dhe sfenoidal anterior të bazës së kafkes
- C)etmoidal dhe maxilar
- D)etmoidal dhe sfenoidal

93.Cili projektion i sinuseve, tregon një imazh simetrik të pjesës anteriore të bazës së kafkes:

- A)lateral
- B)submentovertikale
- C)PA axial, metoda Caldwell
- D)parietocantial, metoda Waters

94.Në cilin projektion të sinuseve, kaseta është e centruar në nasion:

- A)lateral
- B)submentovertikale
- C)PA axial, metoda Caldwell
- D)parietocantial, metoda Waters

95.Në cilin projektion të sinuseve, linja mentomeatale është afërsisht perpendikulare me planin e kasetës:

- A)lateral
- B)submentovertikale
- C)PA axial, metoda Caldwell
- D)parietocantial, metoda Waters

96.Në cilin projektion të sinuseve, linja orbitomeatale duhet të formojë një kënd 15 gradë me kasetën:

- A)lateral
- B)submentovertikale
- C)PA axial, metoda Caldwell
- D)parietocantial, metoda Waters

97.Cili kriter vlerësues i përket projektionit lateral të sinuseve paranazale:

- A)duhet të përfshihen të katërt grupet e sinuseve
- B)piramida petroze duhet të shtrihet në një të tretën e poshtme të orbitave
- C)protuberanca mentale duhet të jetë e superimpozuar nga kocka frontale anteriore
- D)piramida petroze duhet të shtrihet nën dyshtemenë e sinuseve maxilare

98.Cili kriter vlerësues i përket projektionit lateral të sinuseve paranazale:

- A)dyshtemetë e orbitave duhet të jenë të superimpozuar
- B)piramida petroze duhet të shtrihet në një të tretën e poshtme të orbitave
- C)kondilet mandibulare duhet të jenë anteriorisht cristës petroze
- D)protuberanca mentale duhet të jetë e superimpozuar nga kocka frontale anteriore

99.Cili kriter vlerësues i përket projektionit PA axial, metoda Caldwell e sinuseve:

- A)duhet të përfshihen të katërt grupet e sinuseve
- B)duhet të vizualizohen sinuset frontale dhe etmoidale

- C) kondilet mandibulare duhet të jenë anteriorisht piramidave petroze
- D) piramida petroze duhet të shtrihet nën dyshemenë e sinuseve maxilare

100. Cili kriter vlerësues i përket projeksionit parietoacantial, metoda Waters e sinuseve paranazale:

- A) duhet të përfshihen të katërt grupet e sinuseve
- B) piramida petroze duhet të shtrihet në një të tretën e poshtme të orbitave
- C) protuberanca mentale duhet të jetë e superimpozuar nga kocka frontale anteriore
- D) piramida petroze duhet të shtrihet nën dyshemenë e sinuseve maxilare

101. Cili kriter vlerësues i përket projeksionit submentovertikal të sinuseve paranazale:

- A) rami mandibular duhet të jetë i superimpozuar
- B) sinusi frontal dhe etmoidal duhet të shihen qartë
- C) protuberanca mentale duhet të mbivendoset me kockës anteriore frontale
- D) crista petroze duhet të shtrihet nën dyshemenë e sinuseve maxilare

102. Cili kriter vlerësues i përket projeksionit submentovertikal të sinuseve:

- A) crista petroze duhet të shtrihet në një të tretën e poshtme të orbitave
- B) kondilet mandibulare duhet të jenë anteriorisht cristës petroze
- C) kondilet mandibulare duhet të jenë posteriorisht cristës petroze
- D) crista petroze duhet të shtrihet menjëherë nën dyshemenë e sinuseve maxilare

103. Cila metode projeksioni prodhon një pamje axiolaterale të mastoidit:

- A) metoda Waters
- B) metoda Arcelin
- C) metoda Stevens
- D) metoda Law e modifikuar

104. Cili projeksion kërkon që rrezja qendrore, të jetë e drejtuar 15 gradë kaudalisht:

- A) parietoacantial, metoda Waters
- B) axiolateral oblik (metoda Arcelin, profili anterior)
- C) axiolateral oblik (metoda Stevens, profili posterior)
- D) axiolateral (metoda Law e modifikuar, këndim me tube të vetëm)

105. Cili projeksion kërkon që koka e pacientit të rrotullohet nga projeksioni i vërtetë lateral, duke e lëvizur fytyrën afer kasetës derisa plani midsagital të formojë një kënd 15 gradë me kasetën:

- A) parietoacantial, metoda Waters
- B) axiolateral oblik (metoda Arcelin, profili anterior)
- C) axiolateral oblik (metoda Stevens, profili posterior)
- D) axiolateral (metoda Law e modifikuar, këndim me tube të vetëm)

106. Cili projeksion kërkon që rrezja qendrore, të hyje me rreth 5 cm posteriorisht dhe 5 cm superiorisht meatusit akustik ekstern:

- A) parietoacantial, metoda Waters
- B) axiolateral oblik (metoda Arcelin, profili anterior)



- C)axiolateral oblik (metoda Stevens, profili posterior)
- D)axiolateral (metoda Law e modifikuar, këndim me tube të vetëm)

107.Për projektionin aksiolateral (metoda Law e modifikuar, këndim me tub të vetëm), me sa gradë dhe në cilin drejtim duhet të drejtohet rrezja qendrore:

- A)10 gradë kaudad
- B)10 gradë cefalik
- C)15 gradë kaudad
- D)15 gradë cefalik

108.Cili kriter vlerësues i përket projektionit axiolateral (metoda Law e modifikuar, këndim me tub të vetëm):

- A)crista petroze duhet të shtrihet në 1/3 e poshtme të orbitave
- B)crista petroze duhet të jetë e treguar në profil pa distrocion
- C)procesi mastoid duhet të jetë i projektuar nën hijen e kockave oksipitale
- D)mastoidi pranë kasetës duhet të përfshihet, me qelizat e ajrit të demonstruara dhe të centruara në kasetë

109.Me sa gradë dhe në cilin drejtim duhet të drejtohet rrezja qendrore për projektionin axiolateral oblik (metoda Stevens, profili posterior):

- A)10 gradë kaudad
- B)10 gradë cefalik
- C)12 gradë kaudad
- D)12 gradë cefalik

110.Me sa gradë dhe në cilin drejtim duhet të drejtohet rrezja qendrore, për projektionin axiolateral oblik (metoda Arcelin, profili anterior):

- A)10 gradë kaudad
- B)10 gradë cefalik
- C)12 gradë kaudad
- D)12 gradë cefalik

111.Cili kriter i përket projektionit axiolateral oblik (metoda Stevens, profili posterior):

- A)crista petroze duhet të shtrihet në 1/3 e poshtme të orbitave
- B)crista petroze duhet të jetë e treguar në profil pa shtremberime
- C)procesi mastoid duhet të jetë i projektuar nën hijen e kockave oksipitale
- D)mastoidi pranë kasetës duhet të përfshihet, me qelizat e ajrit të demonstruara dhe të centruara në kasetë

## **9. Anatomi**

1.Cila nga brinjët e mëposhtme nuk është atipike:

- A)Brinja e parë
- B)Brinja dytë
- C)Brinja e tretë
- D)Brinja e dymbëdhjetë

2. Brinjët e vërteta janë brinjët :

- A) Nga 1-7
- B) Nga 1-10
- C) Nga 1-12
- D) Asnjëra

3. Angulus sternum formohet nëpërmjet:

- A) Manubrium sternum dhe corpus sterni
- B) Manubrium sternum dhe incisura costale
- C) Manubrium sternum dhe brinjës
- D) Asnjëra

4. Shtylla kurrizore ka funksionet e mëposhtme :

- A) Mbrojtës
- B) Mbështetës
- C) Lëvizor
- D) Të gjitha

5. Incisura costale ndodhet në:

- A) Vetëm në Manubrium sternumi
- B) Corpus sternumi
- C) Mandibul
- D) Vetëm në brinjë

6. Shtylla kurrizore paraqitet e lëvizshme me përjashtim të regjionit:

- A) Cervical
- B) Thoracal
- C) Lumbar
- D) Sacro-cocsigal

7. Shtylla kurrizore paraqitet më e shkurtër tek:

- A) Adulti
- B) Moshuari
- C) Adulti dhe i moshuari
- D) Asnjëra

8. Brinjët nuk lidhen me:

- A) Proceset transversal të vertebrave
- B) Sternumi
- C) Scapula
- D) Trupat e vertebrave

9. Procesi spinos i vertebrave torakale është:

- A) Në formë katrore
- B) Spina bifida

- C) Në formë të tjegullave të catisë
- D) Asnjëra

10. Nuk ka trup asnjë nga kockat e:

- A) Klonoses vertebrale
- B) Rregjionit krural
- C) Karpeve
- D) Femuri

11. Mbledhja e muskujve quhet:

- A) Aduksion
- B) Abduksion
- C) Flexion
- D) Extension

12. Pelvisi formohet nga kockat e mëposhtme me përjashtim të:

- A) Oss coxae
- B) Oss sacrum
- C) Oss coccygeum
- D) Vertebrës lumbare të pestë

13. Skapula nuk ka:

- A) Fose glenoidale
- B) Fose subskapulare
- C) Fose supraspinate
- D) Fose infraspinate

14. Humerusi nuk ka:

- A) Fose olekrani
- B) Fose kapitis
- C) Fose radiale
- D) Fose koroide

15. Nuk i takon kafkës:

- A) Calvaria
- B) Promontorium
- C) Glabella
- D) Clivus

16. Procesi zigomatik mungon tek:

- A) Kocka frontale
- B) Kocka zigomatike
- C) Kocka temporale
- D) Maxilla

17. Atlasi nuk ka:

- A)Procese artikulare
- B)Foramen transversal
- C)Fovea dentis
- D)Dy tuberkulume

18.Është proces i skeletit torakal:

- A)Procesus stiloideus
- B)Procesus xipfoideus
- C)Procesus mamillaris
- D)Procesus zygomaticus

19.Nuk e gjejmë tek sacrum:

- A)Facies articularis
- B)Linea transversal
- C)Cornua sacralia
- D)Spina sacralis

20.Cili nga muskujt e mëposhtëm nuk fillon me dy koka:

- A)Rectus femoris
- B)Digastrikus
- C)Pronator teres
- D)Gastrocnemius

21.Artikulacioni temporomandibular është i tipit:

- A)Cilindrik
- B)Sferik
- C)Elipsoid
- D)Enarthrosis

22.Muskujt pektoralë i takojnë:

- A)Abdomenit
- B)Pelvisit
- C)Shpinës
- D)Toraksit

23.Muskujt e përtpjes inervohen nga:

- A)N. facial
- B)N. vagus
- C)N.trigeminal
- D)Asnjëra

24.Muskujt e mimikës:

- A)Lëvizin manibulën
- B)Inervohen nga n. facial
- C)Kanë inervime të ndryshme nga njëra -tjetra
- D)Kanë dy pika fiksime në kocka

25. Shtrin parakrahun:

- A) m. ekstensor karpi radial longus
- B) m. ekstensor karpi radial bravis
- C) m. ekstensor karpi ulnar
- D) m. triceps brakial

26. M. deltoideus fiksohet në:

- A) Oss scapula
- B) Oss Clavikula
- C) Oss humerusi
- D) Vertebra e tretë

27. Artikulacioni coxo-femoralis është:

- A) Inkogurent
- B) Kongurent
- C) Pjesërisht inkogurent
- D) Asnjëra

28. Në artikulacionin coxo-femoralis bëhen lëvizjet rreth:

- A) Tre boshteve
- B) Dy boshteve
- C) Tre dhe më shumë boshteve
- D) Vetëm rreth një boshti

29. Artikulacioni genu realizohet ndërmjet:

- A) Femurit, tibies, fibules
- B) Femurit, tibies, patelles
- C) Femurit dhe tibies
- D) Femurit, fibules dhe patelles

30. Në lidhjet e kafkës mbizotërojnë:

- A) Artikulacionet
- B) Suturat
- C) Ligamentet
- D) Sinkondrozat

31. Cili nga të mëposhtmit, është funksion i membranës qelizore:

- A) inicicion transduksionin e sinjalit
- B) transporton jone dhe molekula te tjera
- C) formon kanale selective
- D) të gjitha

32. Qelizat shpenzojnë rreth 40% të energjisë së tyre ditore në procesin e:

- A) transport aktiv
- B) endocitoze

- C)exocytose
- D)difuzion të lehtësuar

33.Me cilin lloj procesi transportohet glukoza prej proteinës mbartëse nga një zonë me përqendrim më të lartë, drejt një zone me përqendrim më të ulët:

- A)transport aktiv
- B)endocitozë
- C)difuzion i lehtësuar
- D)difuzion i thjeshtë

34.Pjesa e sistemit nervor që konsiderohet e pavullnetshme është:

- A)SN somatic
- B)SN autonom
- C)SN sensor
- D)SN motor

35.Invaginimet e sarkolemës që formojnë zgjatime në formë gishtërinjsh, që depërtojnë në brendësi të fibrës muskulare quhen:

- A)retikulum sarkoplazmik
- B)retikulum endoplazmatik
- C)tubujt T
- D)filamentet e aktines

36.Segmenti i miofibrilit i quajtur sarkomer, gjendet midis:

- A)dy linjave Z
- B)dy bandave A
- C)dy zonave H
- D)dy aktinave

37.Në një sinaps neuro-muskular, neuroni e çliron neurotransmetuesin në:

- A)pllakën motore
- B)citoplazmën e qelizës muskulare
- C)cisternat terminale
- D)hapësirën sinaptike

38.Një njësi motore përbëhet nga:

- A)të gjitha fibrat muskulare brenda një muskuli të caktuar
- B)nga një neuron motor dhe fibrat muskulare që ai kontrakton
- C)të gjitha neuronet që inervojnë një pjesë të caktuar të trupit
- D)një muskul dhe një nerv

39.Nuk është shenjë e inflamacionit:

- A)Dhimbja
- B)Skuqja
- C)Temperatura
- D)Hypertensioni arterial

40.Një nga molekulat e mëposhtme bën të mundur që muskuli të sigurojë energjinë e nevojshme për kontraksion, duke gjeneruar ATP prej ADP. Ajo është:

- A)creatin fosfati
- B)fosfokinaza
- C)acetilkolinesteraza
- D)katalaza

41.Ku ndryshon fizilogjia e kontraksionit muskular midis muskulit të lëmuar dhe atij të strijuar:

- A)muskuli i lëmuar kontrahet më shpejt se ai i strijuar
- B)muskuli i strijuar përdor dy neurotransmetues, ai i lëmuar vetëm një
- C)muskuli i lëmuar shfaq aktivitet spontan dhe mund të modifikohet nga veprimi i HO
- D)muskuli i lëmuar nuk përmban të njëjtët elemente tkurrës si ai i strijuar

42.Cila nga qelizat e mëposhtme prodhon antikorpe:

- A)limfocitet T
- B)limfocitet B
- C)monocitet
- D)fagocitet

43.Degëzimet nervore të cilat përcjellin impulsin drejt trupit të neuronit, quhen:

- A)aksone
- B)dentrite
- C)trupa Nissl
- D)neurofibrile

44.Sistemi nervor autonom nuk inervon:

- A)muskulin kardiak
- B)gjendrat egzokrine
- C)muskulin skeletik
- D)traktin tretës

45.Lidhur me përcimin e impulsit nevor, nuk është e saktë që:

- A)përcimi i impulsit nervor bëhet sipas ligjit gjithcka ose asgjë
- B)një stimulim me intensitet më të lartë shkakton impulse më të fuqishme
- C)përcimi i impulsit në fibrat e mielinizuara bëhet me kërcim nga një nyje Ranvier në tjetrën
- D)arritja e potencialit të veprimit rrit përshkueshmërinë e membranës aksonale

46.Neurotransmetuesit të cilët rrisin permeabilitetin e membranës post sinaptike për jonet Na dhe potencojnë impulsin nervor, quhen neurotransmetues:

- A)inhibitorë
- B)eksitues
- C)aktive
- D)neutral

47.Pjesa fillestare e harkut reflektor është:

- A) interneuroni
- B) fijet efektore
- C) receptorët ndijesor
- D) neuroni motor

48. Aktiviteti elektrik i muskullit, vlerësohet me:

- A) EEG
- B) EMG
- C) ECG
- D) MRI

49. Cili është rajoni i retinës që përgjigjet për mprehtësinë e pamjes:

- A) sclera
- B) lëngu qelqor
- C) fovea centralis
- D) disku optic

50. Shkopinj të janë qeliza fotoreceptore, që përgjigjen për:

- A) informacionin në errësirë
- B) për ngjyrën dhe detajet e objekteve
- C) informacionin në dritë të bollshme
- D) për ngjyrën, detajet e objekteve dhe informacionin në dritë të bollshme

51. Kontrolli i çlirimit hormonal bëhet nga organizmi me të gjitha rrugët e mëposhtme, përveç:

- A) feed-back negative
- B) stimulim nervor
- C) çlirim i HO kontrolluese
- D) auto destruksion i gjendrës endocrine

52. Hormonet e mëposhtme çlirohen nga antehipofiza, përveç:

- A) FSH
- B) TSH
- C) ACTH
- D) HAD

53. Hormoni i prodhuar në kortexin e gjendrës mbiveshkore që vepron në veshkë duke mbajtur Na e duke eliminuar K dhe që indirekt ndikon në ruajtjen e presionit arterial, është:

- A) aldosteroni
- B) epinefrina
- C) kortizoli
- D) adrenalina

54. Rritja e nivelit të hormoneve të tiroides në gjak jep efektet e mëposhtme, përveç:

- A) rënie në peshë
- B) rritje të metabolizmit bazal
- C) rritje të debitit kardiak



D)rënie të metabolizmit të karbohidrateve

55.Cila pjesë (element) i eritrocitit mund të riciklohet në palcën e kockave, për prodhimin e eritrociteve të reja:

- A)globina
- B)i gjithë eritrociti
- C)biliverdina
- D)hekuri

56.Cili nga përbërësit ushqimor është më i rëndësishëm për prodhimin e eritrociteve:

- A)Ca
- B)Na
- C)proteinat
- D)vitamina B12 dhe acid Folik

## 10. Nefro, Neuro

1.Cila alternativë përshkruan në mënyrë të saktë, fazat e hemostazës:

- A)koagulim i gjakut, formim i trombit, spazmë e enës së gjakut
- B)formim i trombit, koagulim i gjakut, spazmë e enës së gjakut
- C)spazmë e enës së gjakut, formim i tapës trombocitare, formim i koagulit
- D)spazmë e enës së gjakut, koagulim i enës së gjakut, formim i trombit

2.Një person që ka bërë infarkt të muskulit të zemrës, probabilisht ka një bllokim të:

- A)A pulmonare
- B)v. cava
- C)vv. coronare
- D)A coronare

3.Valvulat atrio ventrikulare gjatë ciklit kardiak, mbyllen:

- A)kur pace-makeri dërgon një impuls
- B)kur presioni brenda atriumeve është më i madh se presioni brenda ventrikujve
- C)kur ventrikujt kontrahohen
- D)kur presioni në aortë është më i madh se VM

4.Cila pjesë e zemrës funksionon si pacemaker duke dërguar impulse:

- A)nyja sino-atriale
- B)nyja atrio-ventrikulare
- C)fijet Purkinje
- D)tufa e Hiss

5.Kompleksi QRS në ECG tregon:

- A)depolarizim të atriumeve
- B)depolarizim të ventrikujve para kontraksionit
- C)repolarizim të ventrikujve
- D)zemrën në qetësi

6.Ç'lloj imuniteti japin vaksinat:

- A)imunitet artificial të fituar pasiv
- B)imunitet natyral aktiv
- C)imunitet natyral pasiv
- D)imunitet artificial të fituar aktiv

7.Cili është funksioni i mëlçisë në digjestion:

- A) prodhon enzima digjестive
- B)prodhon lëndë alkaline për të neutralizuar aciditetin e stomakut
- C)prodhon bilë për të emulguar yndyrnat në zorrën e hollë
- D)prodhon substanca që ndihmojnë zorrën e trashë në absorbimin e ujit

8.Çfarë e inicion reflexin e gëlltitjes:

- A)frika nga gëlltitja
- B)gjuha që vërtitet në gojë
- C)receptorët sensorë që ndiejnë ushqimin në farings
- D)receptorët e shijes

9.Receptorët e dëgjimit vendosen në:

- A)kanalet semicirkulare
- B)koklea
- C)sakula
- D)vestibule

10.Cilat qeliza të stomakut sekretojnë faktorin intrinsek:

- A)qelizat e mukozës
- B)qelizat parietale
- C)qelizat peptike
- D)qelizat G

11.Cila nga të mëposhtmet nuk është përbërje e lëngut pankreatik:

- A)kimotripsina
- B)amilaza
- C)bikarbonatet
- D)acidi klorhidrik

12.Yndyrnat thithen në zorrën e hollë si:

- A)acide yndyrore të lira
- B)kilomikrone
- C)acide yndyrore me transport aktiv
- D)triglyceride

13.Lipoproteina që ul tensionin sipërfaqësor të alveolave dhe i bën ato të mos kolabohen quhet:

- A)fosfolipid
- B)lipoproteinë alveolare

- C) surfactant
- D) tensinogjen

14. Sasia maksimale e ajrit që një person mund të expirojë pas frymëmarrjes më të thellë të mundshme, është:

- A) kapaciteti pulmonar total
- B) vëllimi rezervë expirator
- C) vëllimi residual
- D) vëllimi rezervë inspirator

15. Imuniteti qelizor sigurohet nga:

- A) a .makrofagët
- B) bazofilet
- C) qelizat T
- D) qelizat B

16. Oksigjeni transportohet në gjak kryesisht si:

- A) O<sub>2</sub> i tretur në plazëm
- B) deoksihemoglobinë
- C) oksihemoglobinë
- D) karbaminehemoglobinë

17. Cili nga të mëposhtmit nuk është funksion i veshkave:

- A) zhbërthen lëndët ushqimore të ardhura me gjakun
- B) ndihmon në kontrollin e prodhimit të eritrociteve
- C) ndihmon në rregullimin e p. arterial
- D) rregullon përberjen, vëllimin, pH e lëngjeve të organizmit

18. Shëndeti sipas teorisë Bio-Mjekësore është:

- A) Mireqenie shpirtërore
- B) Mireqenie fizike
- C) Mungese e sëmundjes
- D) Mireqenie mendore

19. Shëndeti sipas OBSH është:

- A) Gjendja e mireqenies së plote
- B) Mireqenie fizike dhe shpirtërore
- C) Mireqenie mendore dhe shoqërore
- D) Mireqenie fizike, mendore dhe shoqërore

20. Si duhet të konsiderohet shëndeti:

- A) Në një shkallë lineare
- B) Në një shkallë multidimensionale
- C) Në një shkallë lineare dhe multidimensionale
- D) Asnjëra

21.Shendeti Publik eshte:

- A)Shkenca dhe arti i parandalimit te semundjes
- B)Veprimtari shoqerore dhe politike
- C)Shkenca, arti i parandalimit te semundjes dhe veprimtari shoqerore dhe politike
- D)Asnjera

22.Shendeti Publik e ka fokusin:

- A)Ne popullate
- B)Ne individe
- C)Ne institucionet shendetesore
- D)Ne politikat shendetesore

23.Shendeti Publik e ka fokusin:

- A)Ne parandalimin e semundjeve
- B)Ne sherbimet shendetesore
- C)Ne parandalimin e semundjeve dhe ne sherbimet shendetesore
- D)Asnjera

24.Shendeti publik e ka fokusin:

- A)Diagnostikimin e semundjeve
- B)Ne trajtimin e semundjeve
- C)Ne diagnostikimin e hershem te semundjeve
- D)Asnjera

25.Shendeti publik i "vjeter" konsistonte ne:

- A)Organizimin e sherbimeve shendetesore
- B)Sigurine ushqimore
- C)Organizimin e sherbimeve shendetesore dhe sigurine ushqimore
- D)Asnjera

26.Parimet etike te shendetit publik te "ri" jane:

- A)Barazia dhe solidariteti
- B)Vlerat morale
- C)Mospjesemarrja
- D)Asnjera

27.Karakteristika unike e shendetit publik:

- A)Aplikimi i nje disipline
- B)Aplikimi i trajtimit
- C)Aplikimi i parandalimit
- D)Te gjitha

28.Karakteristika unike e shendetit publik:

- A)Aplikimi i njekohshem i shume disiplinave
- B)Aplikimi i diagnostikimit
- C)Perdorimi i burimeve financiare pa eficince

D)Asnjera

29.Funksionet e shendetit publik te "ri" :

- A)Forcimi i infrastruktures
- B)Udheheqja e punes kerkimore-shkencore
- C)Adaptimi i nje perqasje komunitare
- D)Te gjitha

## 11. Shëndet Publik

1.Fushat e veprimit te shendetit publik te ri:

- A)Adaptimi i nje perqasje multi-faktoriale
- B)Sigurimi i pjesemarrjes se gjere te komunitetit
- C)Forcimi i kapaciteteve institucionale
- D)Asnjera

2.Sfidat e shendetit publik te ri:

- A)Obeziteti
- B)Asbestoza
- C)Kanceri i endometrit
- D)Te gjitha

3.Epidemiologjia studion:

- A)Statistiken
- B)Higjenen
- C)Shpeshtesine e semundjeve
- D)Metodat

4.Faktoret demografike kane te bejne me:

- A)Nivelin e enzimave
- B)Aktivitetin fizik
- C)Grupet etnike
- D)Grupin e gjakut

5.Faktoret biologjike jane si p.sh.:

- A)Gjendja e punesimit
- B)Anti-trupat
- C)Sjelljet seksuale
- D)Te gjitha

6.Faktoret gjenetike jane:

- A)Moshja
- B)Duhanpirja
- C)Konsumi i alkolit
- D)Asnjera

7.Faktoret socio-ekonomike jane:

- A)Aktiviteti fizik
- B)Profesioni
- C)Perdorimi i drogave
- D)Te gjitha

8.Stili dhe menyra e jeteses kane te bejne me:

- A)Duhanpirjen
- B)Sjelljet seksuale
- C)Faktoret dietetike
- D)Te gjitha

9.Qellimi i nje kerkimi epidemiologjik eshte:

- A)Ndricimi i faktoreve etiologjike
- B)Studimet eksperimentale
- C)Studimet transversale
- D)Asnjera

10.Randomizimi ndodh ne:

- A)Studimet transversale
- B)Studimet rast-kontroll
- C)Studimet kohorte
- D)Asnjera

11.Epidemia i referohet:

- A)Rritjes se incidences
- B)Rritjes se prevalences
- C)Rritjes se rriskut relativ
- D)Te gjitha

12.Pandemia i referofehet:

- A)Rritjes incidences
- B)Rritjes se rriskut relativ
- C)Rritjes se prevalences
- D)Asnjera

13.Kurba epidemike perfaqeson:

- A)Incidencen
- B)Imunitetin e grupit
- C)Shperndarjen e periudhave te inkubacionit
- D)Asnjera

14.Fluoroza eshte nje:

- A)Pandemi
- B)Endemi
- C)Epidemi

D)Asnjera

15.Survejanca epidemiologjike eshte:

- A)Pasive
- B)Sentinele
- C)Aktive
- D)Te gjitha

16.Incidenca eshte:

- A)Numri i rasteve te reja
- B)Prevalence
- C)Studim rasti
- D)Te gjitha

17.Prevalenca eshte:

- A)Incidence
- B)Epidemi
- C)Rrisk relativ
- D)Asnjera

18.Studimet deskriptive jane:

- A)Analitike
- B)Vezhguese
- C)Eksperimentale
- D)Asnjera

19.Studimet analitike:

- A)Zbulojne lidhje
- B)Provojne hipoteza
- C)Rrezojne hipoteza
- D)Te gjitha

20.Ne cilat studime, studiuesi luan rol aktiv:

- A)Studimet kohorte
- B)Studimet eksperimentale
- C)Studimet trasversale
- D)Asnjera

21.Studimet kohorte njehsojne:

- A)Prevalencen
- B)Incidencen
- C)Prevalencen dhe incidencen
- D)Asnjera

22.Studimet rast-kontroll:

- A)Jane me kosto te ulet

- B)Jane me kosto te larte
- C)Jane me kosto mesatare
- D)Asnjera

23.Rreziku absolut eshte:

- A)Incidenca e semundjes
- B)Prevalenca e semundjes
- C)Diferenca e rriskut
- D)Asnjera

24.Madhesite e shoqerimit jane:

- A)Madhesi te shpeshtesise
- B)Madhesi te frekuences
- C)Madhesi te semundjes
- D)Asnjera

25.Studimet kohorte jane:

- A)Kosto te ulet
- B)Kosto te larte
- C)Me periudhe te shkurter per tu zhvilluar
- D)Te gjitha

26.Studimet eksperimentale jane:

- A)Eksperimente te mirefillta
- B)Pseudo-eksperimente
- C)Eksperimente te mirefillta dhe pseudo-eksperimente
- D)Asnjera

27.Studimet vezhguese jane:

- A)Observuese
- B)Analitike
- C)Deskriptive
- D)Asnjera

28.Nje lidhje mund te jete:

- A)Statistikore
- B)Shkakesore
- C)Statistikore dhe shkakesore
- D)Asnjera

29.Për ribozomet nuk është e vërtetë që:

- A)Në to kryhet sinteza e proteinave
- B)Përmbajnë arn
- C)Përbëhen nga subuniteti i madh dhe i vogël
- D)Nuk përmbajnë proteina strukturore



30.Nuk është e vërtetë që bërthama:

- A)Ka përmasa të ndryshme në qeliza të ndryshme
- B)Ka forma të ndryshme në qeliza të ndryshme
- C)Permban material gjenetik në trajtën e ADN
- D)Vendoset gjithmonë në qendër të qelizës

31.Gjeni pohimin e gabuar për indin epitelial:

- A)Ka pozicion kufitar
- B)Ka enë gjaku
- C)Ka veti rigjeneruese
- D)Ka polaritet të theksuar në disa lloje qelizash

32.Cili pohim është i gabuar për ADN:

- A)Gjendet vetëm në bërthamë
- B)Shoqërohet nga proteinat histone
- C)Organizohet në kromozome
- D)Organizohet në kromatinë

33.Formimi i njëkohshëm i eritrocitit, trombocitit dhe granulociteve realizohet në:

- A)Nyjen limfatike
- B)Lien
- C)Palcën e kuqe të kockave
- D)Hepar

34.Për neuronin është e gabuar që:

- A)është njësia morfologjike dhe funksionale e indit nervor
- B)nuk ka aftësi të shumohet
- C)aksonet e tij permbajnë lende tigroide
- D)dentritet janë më të shkurtër se aksoni

35.Për pankreasin është e gabuar që:

- A)ka funksion endokrin dhe ekzokrin
- B)indi ekzokrin paraqitet në trajtën e ishujve të langehansit
- C)pjesa ekzokrine përbën pjesën më të madhe të gjendrës
- D)pjesa endokrine prodhon glukagon

36.Në veshkë sintetizohen substancat e mëposhtme, përveç:

- A)Reninës
- B)Eritropoetinës
- C)Aldosteronit
- D)Angiotensinogjenit

37.Epiteli i kavitetit oral është:

- A)Më i keratinizuar i trupit të njeriut
- B)Pseudo-shumështresor prizmatik
- C)I mbuluar në sipërfaqe nga indi muskular

D)Shumështresor i sheshtë

38.Cili është pohim i gabuar për kompleksin golxhi:

- A)vendoset përballë bërthamës
- B)është më i shprehur në qelizat sekretore
- C)në të kryhet trafiku më i madh i makromolekulave
- D)ndërmjet tij dhe rep-it ka komunikim direkt

39.Gjeni pohimin e gabuar në lidhje me bërthamën:

- A)Madhësia e saj është e ndryshme në qeliza të ndryshme
- B)Qelizat kanë gjithmonë vetëm një bërthamë
- C)Ajo mund të gjendet në dy gjendje fizike
- D)Kromatina është përbërja kryesore e bërthamës

40.Cila nga qelizat e mëposhtme nuk është autoktone në indin lidhor:

- A)Fibroblastet
- B)Eozinofilet
- C)Qelizat mezenkimale
- D)Mastocitet

41.Për eritrocitet është e gabuar që:

- A)Kanë bërthamë
- B)Përmbajnë proteinën hemoglobinë
- C)Kanë formën e diskut bikonkav
- D)Kanë funksion transportin e oksigjenit dhe dioksidit të karbonit

## 12. Etikë, Histologji

1.Për eozinofilet nuk është e vërtetë që:

- A)Bëjnë pjesë në seritë granulocitare
- B)Kanë granula specifike me nuancë portokalli
- C)Kanë bërthamë të rrumbullakët
- D)Rritja e numrit të tyre quhet eozinofili

2.Cili funksion nuk i përket neuroglisë:

- A)mbështetës
- B)ushqyes
- C)përcjellës
- D)kufizues

3.Cilat qeliza nuk përbëjnë mukozën e kavititetit nazal:

- A)olfaktore
- B)parietale
- C)mbështetëse
- D)kaliciforme

4.Në lëkurën e hollë mungon shtresa:

- A)Bazale
- B)E shndritshme
- C)Kokrrizore
- D)E brirëzuar

5.Gjeni pohimin e gabuar mbi uterusin:

- A)Përbëhet nga tre shtresa
- B)Është vendi i implantimit të vezës së fekunduar
- C)Epiteli i tij përbëhet nga dy shtresa
- D)Shtresa muskulore është më e holla

6.Fibrocitet kanë tipar karakteristik:

- A)Praninë e zgjatimeve të shumta citoplazmatike
- B)Organelet citoplazmatike të zhvilluara
- C)Formën boshtore të bërthamës
- D)Bërthamën eukromatinike

7.Eritrocitet kanë tipar karakteristik:

- A)Gjatësinë 60-80 milimetër
- B)Ngjyrën blu të bërthamës
- C)Diametrin 7-8 mikrometër
- D)Formën bikonvekse

8.Bazofilia:

- A)Është mungesa e qelizave bazale
- B)Nuk egziston sepse bazofilet përbëjnë më pak se 1% të leukociteve
- C)Është ulja e sasise së bazofileve
- D)Është rritje e numrit të bazofileve

9.Palca e kockave nuk ka funksion:

- A)Hematoklazik
- B)Lokomotor
- C)Retikulo-endotelial
- D)Hemopoetik

10.Fijet muskulare të skeletit, në prerje tërthore janë:

- A)Me formë poligonale
- B)Me pamje të vijëzuar
- C)Pa bërthamë
- D)Me bërthamë në qendër të qelizës

11.Qelizat e mikroglisë në sistemin nervor qendror janë:

- A)Me funksion përcjellës
- B)Me origjinë nga indi muskolor
- C)Me funksion fagocitar

D)Përbërëse të mielinës

12.Mukoza olfaktore në kavitetin nazal mbulon:

- A)Gjithë sipërfaqen
- B)Pjesën superiore
- C)Pjesën më të madhe
- D)Pjesën inferiore

13.Gjendrat sublinguale:

- A)Prodhojnë sekrecion të përzier
- B)Prodhojnë sekrecion vetëm seroz
- C)Nuk kanë gjysmehënëza të xhianucit
- D)Kanë qeliza centroacinare

14.Në përbërje të acinusit pankreatik marrin pjesë edhe:

- A)Ishujt e langerhansit
- B)Qelizat sertoli
- C)Qelizat centroacinare
- D)Qelizat beta

15.Në glomerula:

- A)Përqëndrohet urina
- B)Ka qeliza mezangiale
- C)Nuk ka podocyte
- D)Sintetizohet eritropoetina dhe renina

16.Në terrenet qelizore nuk nevojiten:

- A)Kushtet aseptike
- B)Antinflamatorët
- C)Bujonet organike
- D)Antibiotikët

17.Eutanazia pasive:

- A)Është e pranueshme në stadin terminal të një sëmundje të pashërueshme
- B)Kërkon dhënien e një sërë medikamentesh që përshpejtojnë vdekjen
- C)Zgjat vuajtjen e pacientit
- D)Zbatimi i saj është në kundërshtim me konceptin e së drejtës për të vdekur

18.Egzaminimi objektiv nga pikëpamja etike:

- A)merr për bazë edhe faktorët psikologjikë, shumë të rëndësishëm për pacientin
- B)është më i rëndësishëm se egzaminimi subjektiv
- C)mund të jetë i barasvlefshëm me egzaminimin subjektiv
- D)duhet të jetë gjithmonë i barasvlefshëm me egzaminimin subjektiv

19.Në gjendjen vegetative ndërprerja e ushqyerjes nazogastrike, është e pranueshme sipas:

- A)parimit të totalitetit

- B)konceptit të cilësisë së jetës
- C)konceptit të shenjtërimit të jetës
- D)parimit të konfidencialitetit

20.Sjellja regressive e pacientit e shfaqur gjatë periudhës kalimtare ose të tranzicionit:

- A)është e pakthyeshme
- B)vonon kohën e shërimit të pacientit
- C)është karakteristikë për stadin e tretë ose të konvalishencës
- D)është e nevojshme për pacientin

21.Kujdesi mjekësor paliativ:

- A)konsiston në zgjatjen e jetës së pacientit
- B)vepron mbi shkakun e një sëmundjeje
- C)përdoret në stadin terminal të një sëmundjeje të pashërueshme
- D)përfshin vetëm terapinë psikologjike të pacientit

22.Eutanazia pasive:

- A)zgjat jetën e pacientit
- B)kërkon përdorimin e terapisë intensive
- C)zbatohet në sëmundje të pashërueshme, pavarësisht stadi të sëmundjes
- D)refuzon teprimin terapeutik

23.Konsenti është shprehje e parimit:

- A)utilitarist
- B)të pavarësisë dhe paprekshmërisë së personit
- C)të totalitetit
- D)konfidencialitetit

24.Cila nga simptomat e mëposhtme është shenja kryesore e jatrogjenive:

- A)pagjumësia
- B)djersitja e shtuar
- C)dobësia e përgjithshme
- D)frika (fobia) nga vdekja ose nga ndonjë sëmundje e pashërueshme

25.Cila nga shprehjet e mëposhtme mbi Moralin është e gabuar:

- A)ka të bëjë drejtpërdrejt me veprimet që pasqyrojnë sjelljet e njerëzve
- B)tek morali normat janë të dhëna
- C)ka një domethenie më të gjerë dhe me të thellë sesa Etika
- D)në themel të cdo veprimi moral qëndron fjala "duhet"

26.Në teorinë e jo pasojave:

- A)veprimi është i drejtë nëse ai është i bazuar vetëm në ligje apo rregullore
- B)veprimi është korrekt nëse funksionon dhe nëse është mëse i domosdoshëm
- C)veprimi është i mirë për aq kohë sa efektet janë të mira
- D)veprimi është i mirë nëse nga ky përfiton vetë personi

27. Terapia "mbështetëse" në stadin e tretë të periudhës kalimtare ose të tranzicionit të pacientit:

- A) kryhet nga infermieri
- B) kryhet nga vetë pacienti
- C) kërkon një eksperiencë mjekësore të personelit mjekësor
- D) asnjëra

28. Mjekimi paliativ:

- A) përdoret te një sëmundje e pakurueshme pavarësisht stadi të sëmundjes
- B) përfshin vetëm mjekimin me barna të pacientit
- C) ruan dinjitetin dhe pavarësinë e pacientit
- D) përdoret tek pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike

29. Për cilën nga stadet e periudhës kalimtare ose të tranzicionit, për pacientin është karakteristike sjellja regresive:

- A) stadin e parë
- B) stadin e dytë
- C) stadin e tretë
- D) në të tre stadet

30. Koncepti i cilësisë së jetës, në rrethanat kur jeta e pacientit mbahet në kushte artificiale:

- A) vë theksin tek ekzistenca biologjike e jetës, pavarësisht cilësisë së saj
- B) mbështet konceptin e karakterit të shenjtë të jetës
- C) thekson se jeta e njeriut nuk duhet të zgjatet
- D) mbështet zgjatjen e jetës së pacientit

31. Mohimi i sëmundjes, për cilin stad të periudhës kalimtare ose të tranzicionit është karakteristike:

- A) stadin e parë
- B) stadin e dytë
- C) stadin e tretë
- D) të 3 stadet

32. Plotësimi i detyrës së parandalimit të sëmundjeve, ka çuar në konflikt me parimin e:

- A) universalitetit
- B) mirëbërësisë
- C) konfidencialitetit
- D) barazisë

33. Parimi i pavarësisë së pacientit për të refuzuar mjekimin, hyn në konflikt me parimin:

- A) utilitarist
- B) të barazisë
- C) drejtësisë dhe paanshmërisë
- D) mirëbërësisë

34. Simptoma e hospitalitetit është karakteristike për ata pacientë, të cilët:

- A) nuk e durojnë dot varësinë nga të tjerët

- B) e kanë të vështirë të zbatojnë regjimin e këshilluar
- C) fillojnë të preokupojnë për vetveten që të rifillojnë punën sa më parë
- D) e pelqejnë shumë regresionin dhe duan që ta zgjasin atë pambarim

35. Në cilin rast nuk duhet të respektohet sekretin mjekësor:

- A) sëmundje të trashëguara
- B) somnambulizmi
- C) disa sëmundje të rënda infektive
- D) enuresis nokturna

36. Cili nga pohimet mbi fatkeqësinë mjekësore është i gabuar:

- A) është e lidhur me sëmundje të rënda të pacientit
- B) vjen si pasojë e veçorive individuale të organizmit
- C) vjen si pasojë e një gabimi apo pakujdesie të njeriut të shëndetshëm
- D) është pasojë e ndërlikimeve gjatë procedurave të ndryshme mjekësore

37. Jatrojnitë mund të njihen ndryshe dhe si:

- A) gabime diagnostike
- B) fatkeqësi mjekësore
- C) sëmundje sugjestionuese në mjekësi
- D) gabime terapeutike

38. Lëvizja "Hospice" iu ofron ndihmë:

- A) të sëmurëve kronikë
- B) pacientëve me nivel të ulët ekonomik
- C) të sëmurëve të pashpresë për jetën
- D) të sëmurëve handikapatë

39. Tek pacientet e moshuar, ka:

- A) shtim të perceptimit të dhimbjes
- B) ulje të pragut të dhimbjes
- C) dhimbje atipike
- D) rigjenerim të neuroneve në palcën shpinore

40. Cili nga pohimet që lidhen me Teprimin terapeutik, është i gabuar:

- A) përdoret tek pacientet në stadin terminal të sëmundjes
- B) ka për qëllim zgjatjen e jetës së pacientit
- C) nga pikëpamja etike pranohet në bazë të konceptit të së drejtës për të vdekur
- D) është në përputhje me konceptin e shenjtërimit të jetës

41. Testamenti i jetës:

- A) i paraprin përdorimit të eutanazisë aktive
- B) shkruhet nga pacienti në momentet e fundit të jetës së tij
- C) hyn në fuqi pas vdekjes së pacientit
- D) mbështetet në zbatimin e konsentit

42. Pranimi zyrtar i eutanazisë aktive, do të rritë mundësitë për:

- A) kërkime në fushën e mjekësisë paliative
- B) zbulimin e ndonjë medikamenti të ri për shpëtimin e pacientit
- C) abuzime të ndryshme me pacientët
- D) përjashtimin e ndonjë diagnoze të gabuar në lidhje me pacientin

43. Gabimet mjekësore të shkaktuara nga vetë njerëzit e shëndetësisë, quhen:

- A) gabime diagnostike
- B) jatrogjeni
- C) gabime tekniko - kuruese
- D) gabime taktiko - kuruese

44. Cila nga alternativat e mëposhtme në lidhje me Dashjen kriminale është e gabuar:

- A) bën pjesë në Shkeljet e Kodit Penal
- B) quhet krim mjekësor
- C) bën pjesë në shkeljet e Kodit Deontologjik
- D) kryhet me qëllim nga njeriu i shëndetësisë

45. Në dhimbjen kronike, pacienti:

- A) shfaq grimasa në fytyrë
- B) flet shumicën e kohës për dhimbjen
- C) qan dhe rënkon gjithë kohën nga dhimbja
- D) ka shenja depresioni

46. Vaksinat japin:

- A) imunitet artificial të fituar pasiv
- B) imunitet natyral aktiv
- C) imunitet natyral pasiv
- D) imunitet artificial të fituar aktiv

47. Nuk luan rol mbrojtës në traktin respirator:

- A) hunda
- B) goja
- C) epiteli respirator
- D) leukocitet

48. Ajri rezidual i mushkerive:

- A) matet me spirometer
- B) varion nga 2000-3000 ml
- C) quhet sasia e ajrit që mbetet në mushkeri pas një frymenxjerrje të sforcuar
- D) quhet sasia e ajrit që del gjatë një frymenxjerrje normale

49. Nuk është shenje e inflamacionit:

- A) dhimbja
- B) skuqja
- C) ethja



D)enjtja

50. Adrenalina prodhohet ne:

- A) koren e surenales
- B) pankreas
- C) hipofizen e perparme
- D) koren renale

51. Nivelet mesatare te ekspozimit:

- A) Te destinuar per ekspozimet 15 minuteshe
- B) Te destinuar per ekspozimet 8 oreshe
- C) Nuk duhen te jkaluar per asnje moment
- D) Asnjera